Biblioletra

REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

VITI 7 • NUMRI 3 • 2010



BARKODI PËR LIBRIN

LAVDIE RRAHMANI

Në kohën e zhvillimeve të mëdha teknologjike, derisa bota po ndryshon, praktikat tradicionale në zhvillimin e industrisë së librit po u nënshtrohen transformimeve drastike. Në periudha të tranzicionit ekonomik të një vendi, krijimtaria kulturore dhe intelektuale e botuar duhet të jenë një fokus i rëndësishëm i shoqërisë dhe i zhvillimit të vendit në përgjithësi. Problemet e mëdha ekonomike nëpër të cilat po kalon dhe në të cilat është i fokusuar shteti ynë dhe lënia pas dore e segmenteve të rëndësishme të kulturës, siç është veprimtaria botuese, ndikojnë negativisht në zhvillimet arsimore shkencore në vend dhe si rrjedhojë atakohen edhe fusha të tjera të rëndësishme të zhvillimit të shoqërisë. Vëmendja jo e mjaftueshme ose fare e ulet e shtetit ndaj krijimtarisë kulturore dhe intelektuale të botuar dhe industrisë së botimit të librit në përgjithësi, krijon konsekuenca të paparashikueshme.

Zhvillimet e fundit teknologjike, në botë, kanë sjell risi në praktikat e botimit dhe shtypit të librit dhe si rrjedhojë ato janë modifikuar në mënyrë radikale. Është koha e fundit që edhe ne si shoqëri të ndërmarrim veprime që shpijnë në avancimin e metodave dhe praktikave të botimit të librit, gjithnjë duke respektuar rregullat dhe ligjet në fuqi.

Tani po bëhet gjithnjë e më qartë që në të ardhmen do të jetë e nevojshme dhe e domosdoshme të ndjekim hapin me botën moderne dhe të krijojmë praktika standarde në industrinë e botimit të librit.

/ VIJON NË FAQE 10 /

NË PËRKUJTIM TË NËNË TEREZËS*

Ta fiksosh dhe ta paraqesësh figurën e Nënë Terezës - Gonxhe Bojaxhiut përmes fotografive do të thotë t'u japësh njerëzve mundësinë që t'i njohin disa nga çastet e jetës dhe të veprës së saj të thjeshtë, e njëkohësisht, madhore, gjatë të cilës ajo, me veprën, lutjet, shpirtin, thjeshtësinë, bamirësinë, humanizmin dhe dashurinë e saj engjëllore, i dhuroi njerëzimit modelin më të përsosur të dashurisë së njeriut për njeriun.

Këto çaste të veçanta i ngjajnë një galerie ikonografike, në të cilën, rastësisht apo qëllimisht, është përjetësuar dashuria, dhembja, mëshira, përkushtimi dhe besimi i madh i një shenjtëreshe, e cila, përmes veprave të saj të mëdha, ashtu siç ka vlerësuar Presidenti Historik i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, është bërë themeluese e filozofisë humanitare, që aq shumë i duhet njerëzimit.

Jo rastësisht, në këtë ekspozitë, përmes të cilës po e shënojmë 100-vjetorin e lindjes së Nënë Terezës, kanë zënë vend disa cikle fotografish, të cilat, në mënyrë të gjithanshme, i përfshijnë, përshkruajnë dhe paraqesin vizuelisht disa nga çastet më të rëndësishme në jetën dhe veprimtarinë e bujshme të kësaj shenjtëreshe engjëllore të përmasave botërore, dashuria e madhe e të cilës e ka bërë planetin tonë më të dashur, më human e më të përshpirtshëm.

Gonxhe Bojaxhiu - Nëna Terezë

Kjo ekspozitë e bashkë me të edhe botimi i këtij katalogu përfaqësojnë vetëm një gjest simbolik në këtë përvjetor të rëndësishëm, kur ne qytetarët dhe bashkëkombësit e shtetit e vendit të origjinës së saj, bashkë me kombet e tjera të botës, përulemi e gjunjëzohemi me përshpirtje, me respekt e pietet të jashtëzakonshëm, përballë kujtimit, jetës dhe veprës madhore të kësaj shenjtëreshe, e cila, jo vetëm me gjakun dhe përkatësinë e saj kombëtare, por shumë më tepër me veprën e saj grandioze, e rriti dhe e përjetësoi namin, emrin, nderin dhe dinjitetin e kombit shqiptar në përmasa botërore.

Prishtinë, 16. 12. 2010

Tekst nga parathënia e katalogut: *Jeta dhe vepra e Nënës Terezë: ekspozitë "Gonxhe Bojaxhiu - Nënë Tereza" 100-vjetori i lindjes, MKRS, Prishtinë, 2010*

Në këtë numër

SHKENCA E BIBLIOTEKAVE DHE ALBANOLOGJIA.....5

BKUK NË 66 VJETOR.....7

NË GJURMËT E TË DHËNAVE PËR BIBLIOTEKËN KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS....8

ISBN-13 NË FORMË BARKODI 10

SFIDAT E ARSIMIMIT BIBLIOTEKAR NË EPOKËN E INFORMACIONIT.....14

BIBLIOTEKAT E VEÇANTA NË KUADËR TË BKUK-së 16

E ARDHMJA E LIBRIT DHE BIBLIOTEKAVE - REFLEKSIONE DHE MENDIME...18

BIBLIOTEKA E KONGRESIT.....24

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota
Kryeredaktor: Fazli Gajraku
Këshilli redaktues: Bukurije Haliti, Izet Abdyli, Muharrem Halili, Bedrije Mekolli
Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi
Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

BIBLIOTEKAT KOMBËTARE DHE ALBANOLOGJIA

ADIL OLLURI

Drejtuesit e bibliotekave me pjesëmarrës të Edicionit V të Konferencës

Në përvjetorin e 90'-të (nëntëdhjetë) të saj, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, me datat, 22 dhe 23 nëntor 2010, organizoi në Tiranë Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë, të pestën më radhë. Kjo konferencë organizohet çdo vit në bashkëpunim e bashkorganizim me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, një vit në Prishtinë.

Ashtu, siç u tha edhe nga dy drejtorët gjegjës të dy bibliotekave, Prof. dr. Aurel Plasari dhe Prof. dr. Sali Bashota, organizimi i kësaj konference, si një institucion në vete, ka pasur një synim të vetin, që përpos nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet dy bibliotekave, të nxisë dhe të zhvillojë edhe mendimin bibliotekar shqiptar, me një fjalë zhvillimin e shkencës së bibliotekarisë ndër punonjësit e bibliotekave tona.

Konferenca e radhës e Bibliotekonomisë pati për temë bosht "Shkenca e bibliotekave dhe Albanologjia", në të cilën u trajtuan një sërë aspektesh të përfshirjes, ruajtjes dhe përshkrimit bibliografik e elektronik të njësive apo librave albanologjikë në dy bibliotekat e lartpërmendura.

Në fjalën e tyre përshëndetëse, dy drejtorët e bibliotekave, z. Plasari dhe z. Bashota, theksuan nevojën e bashkëpunimit të mëtutjeshëm ndërmjet dy institucioneve, që ata i drejtojnë, sidomos në fushën e albanologjisë, si në aspektin e librave albanologjikë retrospektiv (të hershëm), po ashtu edhe në aspektin e librave albanologjik perspektiv (të tashëm).

Në këtë konferencë pati një sërë referimesh e kumtesash, nga punonjësit e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, dhe të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Me kumtesa në seancën e parë të ditës së parë u paraqiten: Prof. dr. Sali Bashota: "Bibliotekat e Kosovës dhe Albanologjia" dhe Afërdita Sharxhi: "Hartografia dhe albanologjia, arritje dhe probleme".

Profesor Bashota foli në mënyrë përgjithësuese për librat e natyrës albanologjike, të cilat gjenden në BKUK, por edhe në bibliotekat e tjera të Kosovës. Ai, me trajtesën e tij, dha një informacion të rëndësishëm rreth këtyre librave, si dhe foli për përkushtimin e institucionit, që ai drejton, në pasurimin, ruajtjen dhe përshkrimin bibliografik e elektronik të librave nga fusha e albanologjisë. Ndërsa, Afërdita Sharxhi - nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, pati një vështrim domethënës për ndërlidhjet mes hartografisë dhe albanologjisë, ku u theksua se e pari i jep shumë të dytës, ngaqë hartat si të vjetrat, po ashtu, edhe ato të kohës më të re, janë të një rëndësie të pazëvendësueshme për popullin shqiptar, në këtë rast edhe për albanologjinë.

Në seancën e dytë të ditës së parë, po ashtu, me kumtesa u paraqiten: Jehona Shala: "Bibliotekat Kombëtare - komunikimi albanologjik", Prof. dr. Aurel Plasari: "Çfarë e bën "shqiptar" një bibliotekar" dhe Farfuri Xhaja: "Funksioni albanologjik i Bibliotekës Kombëtare".

Jehona Shala, në kumtesën e saj, theksoi nevojën e një bashkëpunimi dhe të një komunikimi edhe më të madh ndërmjet dy bibliotekave kombëtare, të Shqipërisë dhe të Kosovës. Ajo, po ashtu, dha një informacion të rëndësishëm për punën e BKUK-së rreth fondit albanologjik, që e ka ky institucion.

Prof. dr. Aurel Plasari dha një informacion historik e enciklopedik të fazave të zhvillimit të albanologjisë, duke e ndarë këtë në dy periudha, në atë parashkencore (ku përfshihen dokumentet dhe mendimet e para mbi albanologjinë) dhe atë shkencore

(duke filluar me Hahn dhe Mayer e deri në kohët më të reja). Ligjërata e Plasarit ishte me interes dhe mund t'u hyjë në funksion jo vetëm punonjësve të bibliotekave, por edhe studiuesve të albanologjisë.

Ndërkaq, Farfuri Xhaja nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, foli për rëndësinë dhe funksionin albanologjik, shërbimin e mirë që mund t'ia bëj albanologjisë një bibliotekë kombëtare.

Në seancën e parë të ditës së dytë me kumtesat e tyre u paraqiten: Etleva Domi: "Zhvillimi i koleksioneve albanologjike në mjedisin digjital", Flamur Maloku: "Bibliotekat e veçanta dhe botimet albanologjike", Adil Olluri, Berat Dakaj: "Koleksionet e studimeve albanologjike në BKUK", Fatime Millaku, Besnik Gashi: "Format e pasurimit dhe reflektimi i tyre në albanologji".

Znj. Etleva Domi, zv.drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, theksoi nevojën e digjitalizimit të koleksioneve albanologjike. Kumtesa e saj ishte me interes të veçantë, sidomos për zhvillimin dhe të ardhmen elektronike të bibliotekat tona kombëtare.

Punonjësi i BKUK-së, Flamur Maloku, foli në mënyrë të veçantë për koleksionet dhe botimet albanologjike në bibliotekat e veçanta të institucioneve të ndryshme shkencore, duke vënë spikamën sidomos në Bibliotekën e Akademisë Shkencave dhe Arteve të Kosovës, pastaj atë të Institutit Albanologjik dhe atë të Arkivit të Kosovës, të cilat janë ndër bibliotekat e veçanta kryesore, që kanë fonde albanologjike. Ndërsa, kumtesa e Adil Ollurit dhe Berat Dakajt, kumtesë në bashkautorësi, u prit me interesim nga të pranishmit në konferencë, ngaqë në mënyrë të detajuar jepte informacion rreth pranisë së fondit të studimeve albanologjike në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Njëri nga sesionet e Edicionit V

Ndërkaq, Fatime Millaku dhe Besnik Gashi, në kumtesën e tyre hodhën dritë rreth formave të pasurimit të BKUK-së me fonde të ndryshme të natyrës albanologjike. Ata, gjithashtu, potencuan nevojën e bashkëpunimit edhe më të madh ndërmjet BKUK-së dhe Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, sidomos në shkëmbimin e ndërsjellë të fondit albanologjik, që posedojnë të dy bibliotekat.

Në seancën e dytë të ditës së dytë, që ishte edhe seanca e fundit, me kumtesat e tyre u paraqiten: Behije Luga, Enilda Kola: "Sistemet bibliotekare me burim të hapur, mundësi për krijimin e burimeve elektronike", Suela Ndoja: "Bibliografia dhe albanologjia, vështrim historiko-analitik", Nehat Krasniqi: "Bibliotekat e periudhës osmane në trojet shqiptare".

Nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Behije Luga, në bashkautorësi me punonjësen tjetër, po nga kjo bibliotekë, Enilda Kola, prezantuan aspektet dhe mundësitë e krijimit të burimeve elektronike në bibliotekat tona, gjë që i shndërron ato në institucion me sistem bibliotekar elektronik, pra të hapur për secilin përdorues të mundshëm.

Suela Ndoja nga BKSH-ja, foli në mënyrë të veçantë për ndërlidhjet mes një bibliografie kombëtare dhe koleksioneve albanologjike, duke dhënë edhe një vështrim historik e analitik të këtij problemi, ku siç dihet më parë Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë ka krijuar një bibliografi të veçantë të fondeve albanologjike, të cilat i posedon ky institucion.

Ndërkaq, Nehat Krasniqi, punonjës i BKUK-së, me kumtesën e tij u dha të pranishmëve një pasqyrë dhe një informacion historik për bibliotekat e periudhës osmane në trojet shqiptare, gjë që ishte me interes të posaçëm për historinë e bibliotekave shqiptare, veçanërisht në territorin e Kosovës.

Në këtë konferencë, të pestën me radhë, pati dhe diskutime të rëndësishme rreth problemeve të pasurimit, zhvillimit e informacionit për fondet albanologjike në dy bibliotekat kombëtare, si dhe u nxor një rezolutë nga ana e BKUK-së dhe BKSH-së, ku vihet në pah interesimi i dy drejtorive, asaj në Tiranë dhe asaj në Prishtinë, për një bashkëpunim të ngushtë institucional sa i përket problemeve rreth fondeve të albanologjisë.

REZOLUTË

SHKENCA E BIBLIOTEKAVE DHE ALBANOLOGJIA

Më 22 - 23 nëntor 2010 u mbajt edicioni i pestë me temë Shkenca e bibliotekave dhe Albanologjia i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, si institucion kulturor -shkencor i përbashkët Shqipëri-Kosovë.

Konferenca u organizua në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Ajo trajtoi gjerësisht dhe me profesionalizëm problematika që lidhen me funksionet dhe detyrat e bibliotekave kombëtare të Shqipërisë dhe të Kosovës në fushën e grumbullimit, përpunimit dhe shërbimit të informacionit albanologjik, si pjesë e rëndësishme e përpjekjeve shkencore për afirmimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve, të historisë dhe të kulturës së tyre.

Drejtues dhe specialistë të të dy bibliotekave paraqitën ligjërata dhe kumtesa, në të cilat analizoheshin praktikat, por dhe vizionet e përbashkëta për rolin që luajnë në epokën digjitale bibliotekat kombëtare përkatëse në një fushë të rëndësishme të veprimtarisë së tyre si menaxhimi i burimeve të dijes albanologjike.

Më konkretisht, në konferencë u trajtuan probleme të ndryshme që kishin të bënin me formimin e specialistëve të burimeve albanologjike në të dy bibliotekat tona kombëtare, me funksionet albanologjike të këtyre bibliotekave, zhvillimin e koleksioneve albanologjike në mjedisin digjital, rëndësinë e koleksioneve të hartografisë për albanologjinë, domosdoshmërinë e sistemeve bibliotekare elektronike me burim të hapur, raportet e bibliografisë me albanologjinë në vështrim historiko-analitik, bibliotekat kombëtare dhe komunikimi albanologjik, koleksionet e studimeve albanologjike, format e pasurimit në albanologji, bibliotekat e veçanta dhe botimet albanologjike etj.

Kumtesat e mbajtura u përqendruan në rolin ndërmjetës, por tejet të rëndësishëm, të të dy bibliotekave midis dijeve albanologjike që bartin koleksionet e tyre dhe përdoruesve që e shfrytëzojnë atë, që në këtë rast janë kryesisht lëvrues të shkencave që përbëjnë albanologjinë. Ky pozicion i kahershëm dhe tradicional i bibliotekave kombëtare u trajtua vështruar në kushtet e reja të shoqërisë së informacionit dhe të komunikimit dhe në përputhje me kërkesat specifike të përdoruesve të burimeve albanologjike.

Nisur nga situata konkrete e veprimtarisë në funksion të përpunimit dhe shërbimit të informacionit albanologjik në bibliotekat tona, pjesëmarrësit në konferencë miratojnë rezolutën e mëposhtme:

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës realizojnë me sukses detyrat funksionale që lidhen me rolin e tyre si ndërmjetëse mes dijes albanologjike dhe informacionit të pafund që bartin në koleksionet gjegjëse, nga njëra anë, dhe lexuesit që i përdor ato, nga ana tjetër. Megjithatë, bibliotekat kombëtare të Shqipërisë dhe Kosovës prej kohësh ndiejnë si domosdoshmëri thellimin dhe përmirësimin e veprimtarisë së tyre që ka të bëjë me plotësimin e kësaj detyre themelore, sidomos në kushtet e shoqërisë së informacionit dhe të teknologjive të reja.

Konferenca thekson rëndësinë e një pozicionimi të qartë, të saktë dhe sa më profesional të dy bibliotekave tona në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre albanologjike. Krahas përpjekjeve për integrimin e bibliotekave të Shqipërisë dhe Kosovës në rrjedhat bashkëkohore europiane dhe botërore, bibliotekarët shqiptarë të të dy vendeve duhet të rritin rolin e tyre në mbështetje të zhvillimit të shkencave albanologjike dhe të vlerësojnë maksimalisht informacionin, sidomos atë elektronik, për veprat albanologjike që ruajnë në fondet e tyre.

Më tepër se deri më sot bibliotekat tona duhet të vlerësojnë teknologjitë e informacionit duke i konsideruar ato si mjete të rëndësishme për rritjen e efektivitetit të shërbimeve ndaj përdoruesve, përfshirë edhe shkencëtarët dhe studiuesit albanologë. Sistemet e integruara bibliotekare të të dy bibliotekave mundësojnë bashkëpunim të frytshëm mes tyre, sidomos në dhënien dhe marrjen e informacionit bibliografik të karakterit albanologjik; ndaj, në kuadër të bashkëpunimit në veprimtarinë informuese bibliografike dhe të krijimit të bazave të të dhënave, konferenca e sheh t\ udhës krijimin e një portali të përbashkët Shqipëri – Kosovë që do të ofronte informacion albanologjik apo objekte të digjituara, çfarë do të krijonte më shumë mundësi për shkëmbimin e informacionit dhe përdorim të përbashkët të burimeve. U theksua që për realizimin e kësaj ideje është e domosdoshme mbështetja e organeve vendimmarrëse në të dy vendet.

Konferenca ka besim se Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës si edhe bibliotekat e tjera në të dy vendet që shërbejnë literaturë albanologjike do të ngrenë në një nivel më të lartë angazhimin për plotësimin si duhet të detyrave në një fushë të rëndësishme si ajo e shërbimeve albanologjike duke përmbushur kështu misionin e tyre të rëndësishëm kombëtar dhe kulturor.

Tiranë, më 23 nëntor 2010

DITA E BIBLIOTEKËS

BKUK festoi këtë vit, më 25 nëntor 2010, 66-të (gjashtëdhjetë e gjashtë) vjetorin e themelimit të saj. Në këtë përvjetor të rëndësishëm, u mbajt një manifestim solemn, në të cilin ishin të pranishëm personalitete të rëndësishme nga fusha e politikës, kulturës dhe shkencës.

Në fjalën përshëndetëse, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - prof. dr. Enver Hoxhaj tha se "BKUK është tempull i dijes dhe identiteti ynë kulturor, kontributi i së cilës ka qenë i rëndësishëm për proceset që e kanë përcjellë Kosovën". Ministri Hoxhaj, po ashtu ka folur edhe për nevojën e një përkrahjeje më të madhe për këtë institucion të librit dhe të dijes. Ai shprehi gatishmërinë e tij institucionale që ta ndihmojë Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare në vitin në vijim, duke theksuar se për këtë bibliotekë, sikurse edhe shumë institucione të tjera kulturore e arsimoro-shkencore, qeveria e vendit, konkretisht ministria që ai drejton, ka një interesim të veçantë.

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Prof. dr. Sali Bashota, në fjalimin me rastin e 66-vjetorit, theksoi ndër të tjerash, se fondet e BKUK-së, librat, revistat, hartat, fotografitë, letërkëmbimet etj., tashmë e kanë frymën e tyre të lirë, ku formësohet identiteti kulturor dhe kombëtar dhe përmasa e dijes universale dhe e dijes kombëtare. Ai, po ashtu, shtoi se BKUK në gjysmën e dytë të shekullit XX e ka kërkuar vijimisht identitetin e saj kulturor dhe kombëtar. "Këtij institucioni pesë herë ia kanë ndërruar emrin, ndërsa në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar ia kanë zhdukur një pjesë të madhe të librit shqip, duke i dërguar në fabrikë letre për t'i shndërruar në karton", nënvizoi Bashota. Ai pastaj theksoi se si BKUK e ka krijuar

Selemniteti me rastin e 66-vjetorit të BKUK-së

vetëdijen për trashëgiminë kulturore që posedon duke i pasuruar, zhvilluar dhe përpunuar koleksionet e saj dhe duke i afirmuar vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare në rajon e më gjerë.

Pasi përmendi mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, drejtori Bashota numëroi disa nga veprimtaritë e drejtuesve dhe të punonjësve të këtij institucioni, siç janë: pjesëmarrjen në takime të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare, mbajtjen e manifestimit "Java e Bibliotekës në Kosovë", pjesëmarrjen në Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë (në Tiranë), etj. BKUK me fondet e saj të përgjithshme dhe me fondet të saj, si fondet e Këndit Amerikan, Bibliotekës së Artit Bashkëkohor, Biblioteka e NATO-s, Bibliotekat e veçanta të Fehmi Aganit dhe Krist Malokit, Arkivi i Autorëve, Qendra dokumentare "Kujtesa e Kosovës", të gjitha këto, e bëjnë të veçantë këtë institucion, duke synuar që sa më parë të jetë anëtare e barabartë e institucioneve më të larta bibliotekare.

Me rastin e shënimit të këtij përvjetori, në hollin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, u hap edhe ekspozita "Libri i ri në BKUK", në të cilën u prezantuan të gjithë librat e ri, të ardhur në këtë institucion viteve të fundit. Kjo ekspozitë ishte me interes të veçantë, ngaqë në të pati libra nga të gjitha fushat e mundshme të dijes, shkencës, letërsisë e kulturës. Në të, përpos librave shqip të botuar brenda territorit të Kosovës dhe nga botuesit kosovarë, pati edhe libra të botuar në Shqipëri, Maqedoni dhe treva të ndryshme të banuara me shqiptarë, mirëpo pati edhe një sërë librash në gjuhë të huaj, sidomos libra shkencorë nga shkencat e ndryshme humane, mjekësore, ekonomike etj.

Në vazhdën e traditës së saj të parvjetshme, BKUK edhe sivjet shpalli punëtorin e saj të dalluar për vitin 2010. Me këtë mirënjohje është nderuar Shyqri Haliti, i cili ka dhënë një kontribut të çmueshëm në zhvillimin e kësaj biblioteke në kohë të ndryshme, duke qenë për vite më radhë në shërbim të këtij institucioni.

A.Olluri

BKUK NË 66-VJETOR

PROF. DR. SALI BASHOTA

66 vjet të BKUK-së përballen përbrenda dy shekujve dhe dy kohëve. Biblioteka, librat, doreshkrimet, revistat, gazetat, hartat, fotografitë, letërkëmbimet etj., në BKUK tashmë e kanë frymën e tyre të lirë ku formësohet identiteti kulturor dhe kombëtar dhe përmasa e dijes universale dhe e dijes kombëtare.

Biblioteka Kombëtare e një vendi e paraqet gjendjen e kulturës së një shteti. Biblioteka. Librat. Lexuesit. Këto janë tri shenja të veçanta që kanë domethënie për Kosovën në rrethana të caktuara, sidomos për zhvillimet shoqërore dhe politike të shqiptarëve.

BKUK në gjysmën e dytë të shekullit XX e ka kërkuar vijimisht identitetin e saj kulturor dhe kombëtar. Këtij institucioni pesë herë ia kanë ndërruar emrin, ndërsa në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar ia kanë zhdukur një pjesë të madhe të librit shqip duke i dërguar në fabrikë letre për t'i shndërruar në karton.

Mirëpo BKUK po merr frymë bashkë me lirinë e Kosovës dhe me mbështetjen e fuqishme të institucioneve ndërkombëtare, veçanërisht të miqve amerikanë. Ambasada Amerikane në Prishtinë është mbështetësi më i fuqishëm i këtij institucioni me shumë projekte dhe në shumë drejtime.

BKUK e ka krijuar vetëdijen për trashëgiminë kulturore që posedon duke i pasuruar, zhvilluar dhe përpunuar koleksionet e saj dhe i duke i afirmuar vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare në rajon e më gjerë.

Me idenë himnizuese të kupolave dhe të grilave të saj, madje si shenja të mitizuara etnografike, BKUK është bërë model i stilit të veçantë arkitektonik, me të cilën simbolikisht identifikohet fatit i popullit shqiptar në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar.

BKUK i ka shenjat e veta të veçanta në një kohë dhe në një vend, bashkë me ngjarjet reale të jetës së njerëzve të Kosovës.

Në këtë 66 vjetor po i përmendim vetëm disa të arritura nga nëntori i vitit të kaluar e këndej.

BKUK kujdes të veçantë i ka kushtuar pasurimit dhe zhvillimit të koleksioneve bibliotekare, duke i pasuruar fondet e saj me libra të vjetër dhe të rinj. Në këtë drejtim kanë kontribuar edhe shumë donatorë ndërkombëtarë.

Në Gothenburg të Suedisë, BKUK paraqiti dëshmi, fakte dhe argumente, në Kongresin e 76- të Federatës Ndërkombëtare të Institucioneve dhe Shoqatave Bibliotekave(IFLA) , lidhur me pasojat e dhunës serbe ndaj bibliotekave të Kosovës në përgjithësi dhe ndaj BKUK-së në veçanti , prandaj edhe një herë u dëshmua se e vërteta është në anën e Kosovës.

Gjithashtu, duhet theksuar edhe kontributi i punëtorëve të BKUK-së në pjesëmarrje në edicionin e radhës së punimeve të Unionit të Bibliotekave të Ballkanit në Edirne të Turqisë, ku BKUK është njëri ndër themeluesit e këtij Unioni.

Gjithashtu, veprimtaritë të cilat ndërlidhen me fushat e avancimit të dijes në fushën e bibliotekarisë, siç janë "Java e Bibliotekës në Kosovë", e cila organizohet në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë dhe "Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë", aktivitet që organizohet bashkë me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, kanë kontribuar dhe do të kontribuojnë edhe më shumë në zhvillimin e BKUK-së, por edhe të bibliotekave të Kosovës.

Edicioni i pestë i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, i cili i mbaroi punimet para dy ditësh në Tiranë, ndër të tjera, doli me rezultatin e shumëpritur për fillimin e krijimit të një portali të përbashkët Shqipëri – Kosovë që do të ofronte informacion albanologjik për përdorim të përbashkët të burimeve elektronike në këtë fushë.

BKUK është udhëheqëse e Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës, duke bashkëpunuar me Universitetin e Prishtinës dhe më shumë kolegje private të arsimit të lartë.

Kujdes të veçantë i është kushtuar përpunimit të materialeve bibliotekare në katalogun elektronik të të dhënave dhe deri më tani BKUK i ka të kataloguara mbi 45 mijë njësi bibliografike dhe afër 120 mijë njësi fizike.

BKUK tashmë e ka Qendrën e Trajnimeve, e cila ofron shërbime moderne për të gjitha bibliotekat e Kosovës. Ky projekt është realizuar me donacionin nga ProCredit Bank. Trajnimet e organizuara me punëtorë nga të gjitha llojet e bibliotekave të Kosovës, kanë dëshmuar një sukses në ketë fushë, mirëpo synimi i BKUK-së është hapja e Departamentit të Bibliotekarisë në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës.

Në fushën e botimeve BKUK ka arritur të botojë libra të rëndësishëm profesionalë duke ofruar informacione me interes për standardet më të avancuara dhe më të reja ndërkombëtare në fushën e bibliotekarisë.

Gjithashtu, BKUK është bërë qendër e përurimit të vlerave më të reja në fusha të ndryshme të dijes, me promovimin e veprave të reja.

Ceremonia e nënshkrimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në ambientet e këtij institucioni, si dhe mbajtja e Tribunës Publike e Sekretares së SHBA-ve znj. Hillary Clinton, gjithsesi, kanë domethënie të veçantë për të tashmen dhe të ardhmen e këtij institucioni.

BKUK me fondet e saj të përgjithshme dhe në kuadër të saj, Këndi Amerikan, Biblioteka e Artit Bashkëkohor, Biblioteka e NATO-s, Bibliotekat e veçanta të Fehmi Aganit dhe Krist Malokit, Arkivi i Autorëve, Qendra dokumentare "Kujtesa e Kosovës", të gjitha këto, e bëjnë të veçantë këtë institucion në Ballkan e më gjerë.

Të gjitha këto të arritura të BKUK-së janë realizuar në bashkëpunim të frytshëm me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, por edhe me shumë institucione të tjera qeveritare dhe ndërkombëtare. Prandaj, kam kënaqësi që t'i falënderoj të gjithë.

Gëzuar 66 vjet të BKUK-së.

KONTRIBUT PËR NJË MONOGRAFI

NË GJURMËT E TË DHËNAVE PËR BIBLIOTEKËN KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

MR. SC. TAHIR FONIQI

BIBLIOTEKA POPULLORE KRAHINORE (1961 - 1969)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, e cila është themeluar në nëntor të vitit 1944, në Prizren, ka kaluar nëpër një seri fazash të vështira zhvillimi, zhvendosje, ndërprerje të aktivitetit të saj, ndërrime titullari, statuti etj.

Në këtë shkrim do të përqendrohemi nga një fazë e rithemelimit të saj sërishmi, më 21 nëntor 1961, sipas vendimit të Këshillit Popullor Krahinor numër 4306 me emërtimin: Biblioteka Popullore Krahinore, në të cilën hyn edhe Qendra Bibliotekare e KAKM-së. Ajo themelohet paralel me grupet e para të Fakultetit Filozofik të Prishtinës: Grupi i Matematikës, Grupi i Fizikës, Grupi i Kimisë, Grupi i Biologjisë, Grupi i Gjuhës dhe i Letërsisë serbokroatishte dhe Grupi i Gjuhës dhe i Letërsisë shqipe. Biblioteka fillon punën në janar të vitit 1962, në ndërtesën numër 36 në rrugën "Ramiz Sadiku".

Fillimisht kishte një lokal me dy dhoma me 104 metra katrorë sipërfaqe. Në fillim Biblioteka kishte rreth 1465 libra, 50 vjetarë periodiku dhe materialin për 50 biblioteka lëvizëse, të siguruara përmes dhuratave, koleksioneve të Bibliotekës publike të Prishtinës, Institutit Albanologjik të Prishtinës etj. Në mbarim të vitit 1962, kjo Bibliotekë ka pasur katër njësi organizative: Sekretariati me referatet: referati për çështjet personale dhe organizative, referati i kontabilitetit, referati i daktilobyrosë dhe referati për punët teknike e ndihmëse; Seksioni për përpunimin e librit me: referatin për pranimin e librit, periodikut dhe të materialit tjetër bibliotekar, referati për formimin e skedarëve, si dhe referati për hartimin e bibliografive; Seksioni për përparimin e bibliotekarisë me: referatin e analizës dhe Seksioni për punët me lexues me referatet e depos dhe të sallave.

Gjatë kësaj periudhe, Biblioteka angazhohet sidomos rreth pasurimit të koleksioneve të librit, kryesisht përmes blerjes, organizimit të brendshëm të bibliotekës, shkollimit dhe aftësimit profesional të kuadrit bibliotekar, përparimit të veprimtarisë së bibliotekave në terren, përmirësimit të gjendjes së lokalit bibliotekar të bibliotekave etj. Po ashtu, biblioteka është angazhuar edhe për sigurimin e ekzemplarit të detyrueshëm të gjërave të shtypura në Jugosllavi me qëllim të kompletimit të koleksioneve bibliotekare karshi kërkesave të shtuara të lexuesve, sidomos nga radhët e studentëve.

Që nga gushti i vitit 1963, kjo bibliotekë fillon ta marrë përsëri ekzemplarin e detyrueshëm të gjërave të shtypura të botimeve të Serbisë, ndërsa nga muaji prill 1965, pranon edhe ekzemplarin e detyrueshëm të gjërave të shtypura të Jugosllavisë.

Gjatë kësaj kohe Biblioteka Popullore Krahinore është pasuruar edhe përmes dhuratave. Vetëm gjatë muajve maj-qershor 1962 në Bibliotekë kanë hyrë 2969 libra përmes kësaj forme të furnizimit. Në mbarin të vitit 1964, ky numër arrin në 8038 kopje, të cilat i kanë dhuruar Biblioteka e Fakultetit Juridik të Novi Sadit, Biblioteka Popullore e Karllovcit, Biblioteka Popullore e Serbisë etj.

Më 1964, biblioteka është vendosur në një objekt ku sot është Galeria e Arteve të Kosovës, në të cilin ka zhvilluar veprimtarinë në këtë objekt deri në vitin 1982. Më 15 mars 1965, biblioteka e jep në përdorim edhe sallën e leximit për studentë me 65 ulëse, bashkë me dy skedarë: të autorit dhe atë lëndor (Klasifikimi Universal Decimal). Në këtë vit, ky institucion shpallet Bibliotekë qendrore për territorin e Kosovës, status

që e barazonte me të gjitha bibliotekat e ngjashme të njësive federative të ish-Jugosllavisë.

Në gjysmën e dytë të vitit 1965 Biblioteka Popullore Krahinore ka pasur rreth 47000 kopje libri, të cilat janë shtuar mesatarisht nga 1000 kopje në muaj. Ndërkaq numri i njësive periodike, të hyra në Bibliotekë gjatë viteve 1962-1966, sillej rreth 3300 në vit. Kah gjysma e vitit 1966, biblioteka kishte mbi 50000 kopje të librit.

Viti 1967 është i rëndësishëm për këtë bibliotekë meqë, për herë të parë, fillon shkëmbimin e materialit bibliotekar me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. Gjatë vitit 1967 kjo bibliotekë jonë ka marrë nga Shqipëria, 120 tituj librash e 35 kopje të periodikut. Gjatë viteve 1968-1969 në bibliotekë formohen edhe tri seksione: Seksioni i Bibliografisë, Seksioni për Pasurimin e Fondeve dhe Seksioni për Mbrojtjen dhe Shumëzimin e Materialit Bibliotekar.

BIBLIOTEKA POPULLORE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS (1970 - 1990)

Më 1970, Kuvendi Krahinor i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nxjerr Ligjin për themelimin e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës me qëllim që "të përhapë arsimin dhe kulturën e përgjithshme dhe të ndihmojë në punën shkencore profesionale, si dhe t'i plotësojë nevojat kulturore në sferat e tjera të jetës". Kështu, Biblioteka merr funksion të dyfishtë: të bibliotekës së përgjithshme me karakter shoqëror e kulturor dhe të bibliotekës me karakter shkencor e hulumtues – si bibliotekë universitare. Më 1973, kjo bibliotekë ka pasur 202271 njësi bibliotekare të përpunuara: libra e periodikë. Më 1976 Biblioteka i pasuron fondet e veta edhe me 23490 njësi të librit: 19274 - përmes ekzemplarit të detyrueshëm, 3579 - përmes blerjes, 502 - përmes shkëmbimit e 135 - përmes dhuratës. Në anën tjetër, Seksioni i periodikut përpunon 650 tituj të rinj apo 5770 vëllime, përkatësisht 31755 fletushka. Prej këtyre 65 tituj ishin në gjuhë të huaja.

Gjatë periudhës 1973 - 1984, në bibliotekë pavarësohen edhe katër seksione profesionale: Seksioni për Përpunimin e Periodikut, Seksioni i Skedarit të Autorit, Qendra Referale dhe Seksioni i Fondeve të Veçanta.

Më 25 nëntor 1982 përurohet objekti i ri, modern, i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës, në të cilin tash është, me 16500 metra katrorë sipërfaqe (ndërtimi ka filluar më 1975, ndërsa ka përfunduar më 1981). Biblioteka, në kë kohë kishte rreth 700000 njësi bibliotekare.

Nga viti 1983, në bibliotekë organizohen edhe provimet profesionale të bibliotekarisë, ku punëtorët e bibliotekës marrin, për herë të parë marrin titujt profesional bibliotekar.

Në fund të vitit 1986, Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës kishte 563828 njësi bibliotekare të botimeve monografike dhe 9784 tituj të botimeve serike - 6888, të revistave, ndërsa 2896 të gazetave. Në Fondin e Veçantë ishin rreth 600 njësi libri në gjuhët orientale, si dhe 150 dorëshkrime në gjuhën arabe, turko-osmane e persishte e dorëshkrime shqipe me alfabetin arab. Këto materiale janë siguruar nëpërmjet ekzemplarit të detyrueshëm, blerjes, shkëmbimit dhe dhuratave. Sipas librave të inventarit të Bibliotekës, gjatë viteve 1944-1986, në Bibliotekë, nëpërmjet dhuratës, kanë hyrë 40986 njësi bibliotekare, shumica në gjuhën shqipe. Këto njësi janë dhuruar nga institucione dhe individë. Janë të mirë njohura materialet bibliotekare të dhuruara nga Mehmet Gjevori - 1780 tituj, Shaqir Kastrataj - 1638, Stathi Kostari - 408, Talat e Shani Pallaska - 350, Mark Krasniqi 314, si dhe dhuratat e tjera që kanë hyrë në vijimësi, të dhuruara nga shumë intelektualë e veprimtarë të njohur shqiptarë.

Gjatë viteve 1962-1986 Biblioteka ka blerë 86378 njësi bibliotekare shkencore nga individët, si: Hasan Kaleshit - 1625 njësi në gjuhën: shqipe, serbokroate, turke, arabe, frënge, angleze, gjermane, ruse, bullgare, italiane, greke, hungareze, çeke, maqedone; Nikola Belocerkovcit - 1522, Drag. Ikoviqit 329, Sadulla Brestovci 128 etj.

Më së shumti njësi bibliotekare janë blerë më 1978 - 9500. Nëpërmjet shkëmbimit, gjatë viteve 1973 - 1986, kjo bibliotekë është pasuruar me 4150 njësi bibliotekare. Ky shkëmbim është bërë me Shqipërinë, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Bibliotekën e Kongresit Amerikan, Bibliotekën Shtetërore të Rumanisë, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë etj.

Nga viti 1981, kjo bibliotekë i nënshtrohet një kontrolli të fortë shtetëror, që ishte në dëm të pasurimit të kësaj biblioteke me fond albanologjik. Vit pas viti, shtrëngesat dhe represioni bëhet më i madh, ndërsa që represioni politik e shtetëror serb rritet. Ky represion arrin kulmin në fillim të viteve '90, kur kjo bibliotekë administrohet nga masa të dhunshme serbe. Punëtorët shqiptarë u përzunë nga puna, ndërsa që gradualisht u ndalua pasurimi i bibliotekës me koleksione në gjuhën shqipe, kurse shumë nga njësitë bibliotekare iu nënshtruan një revizioni serb diskriminues, duke i dëmtuar rëndë fondet në gjuhën shqipe, të cilat u tërhoqën nga fondet e bibliotekës, u shkatërruan, duke u dërguar madje edhe në fabrika të përpunimit të letrës. Pra, në vitin 1990, biblioteka, nën masat e dhunshme serbe, emërohet si: Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës dhe Metohisë.

BARKODI PËR LIBRIN

/ VIJON NGA BALLINA /

ISBN-13 NË FORMË BARKODI

Sistemi i ISBN-së shërben si element kyç i porosisë, sistemimit dhe inventarizimit për botuesit, shitësit dhe bibliotekat. ISBN-ja është bazë për mbledhjen e të dhënave për botimet e reja të librave kudo në tregtinë e librit. Përdorimi i ISBN-së gjithashtu lehtëson menaxhimin dhe monitorimin e të dhënave të shitjes në industrinë e librit.

Versioni i ripunuar i ISO-s 2108 (International Organization for Standardization) - *Information and Dokumentation - International Standard Book Number (ISBN),* i publikuar me 2005, prezanton ndryshimin e parë të bërë në strukturën e ISBN-së që nga fillimi i përdorimit të tij dhe ky ndryshim çon në zgjerimin e numrit nga 10 në 13- shifrorë.

Që nga 1 janari i vitit 2007, librat në gjithë botën bartin ISBN-13 shifrorë në vend të ISBN-10 shifrorë, që ishte përdorur deri atëherë.

Një kohë të gjatë barkodet janë përdorur nga libraritë dhe bibliotekat vetëm për të procesuar librat. Ata janë printuar në fund të kopertinës së pasme të librit në anën e djathtë. ISBN-ja është printuar mbi barkod. Kjo ishte praktikë standarde në industrinë e botimit të librit. Ndonjë ndryshim në çmim pas lëshimit të barkodit do të kërkonte barkod të ri. Këto kode janë përdorur për shitësit me pakicë të cilët kanë shitur edhe produkte të tjera veç librit. Është e rëndësishme të theksohet se *Bookland EAN barkodi* është ndryshe nga kodet universale të prodhimeve (Universal Product Code). Në përgjithësi vetëm marketet e mëdha kanë pasur të dy llojet edhe *Bookland EAN* edhe *UPC codin* të printuar në kopertinën e mbrapme të librit.

ISBN dhe barkodi janë dy gjëra të ndryshme. Barkodi është një grafik me vija vertikale të cilat dekodojnë informacionin numerik për qëllime të skanimit.

ISBN është numër i cili identifikon botuesin, titullin, autorin, botimin, gjuhën e librit etj dhe përdoret në industrinë e librit për të shpejtuar funksione si: shpërndarja, shitja/porosia, kontrolli bibliografik, katalogimi, huazimi ndërbibliotekar etj.

ÇFARË LLOJ BARKODI I NEVOJITET LIBRIT TUAJ!?

Shtrirja e shpejtë në gjithë botën e përdorimit të barkodit ka imponuar arritjen e një marrëveshjeje midis Organizatës Ndërkombëtare EAN (European Artical NUmber), e cila vendos standarde për numërimin e produkteve përmes barkodit, The Uniform Code Council (UCC) dhe të Agjencisë ndërkombëtare të ISBN-së.

Kjo marrëveshje, lejoi konvertimin e ISBN-së në *EAN barkod*. Kështu ISBN u bë një identifikues internacional brenda një skeme të barkodit në gjithë botën. Simbolet e barkodit të shfaqura në kopertinën e pasme të librave janë të njohura si *Bookland EAN* ose *ISBN-13 barkod* simbole. Lloji i barkodit është i njëjti si të tjerët që përdoren për mallra të ndryshme, mirëpo sistemi i numërimit që përdoret për të gjeneruar barkodin është i ndryshëm. *EAN* për produkte normale në shitje është numër 13 shifrorë, i cili në mënyrë unike identifikon atë produkt. Libri identifikohet me numrin e vet unik, International Standard Book Number (ISBN). *EAN barkodi* për libër gjenerohet nga ISBN-ja. Një EAN (European Artical Number) barkod është ISBN e librit tuaj e transferuar në OCR (Optical Character Readable) imazh i skanuar.

Shembull i konvertimit të ISBN-së në ISBN Bookland EAN:
ISBN me shifrën kontrolluese
9951-00-027-4
ISBN pa shifrën kontrolluese
9951-00-027
Kur i shtohet EAN identifikuesi i artikullit
978995100027
Kur i shtohet EAN shifra e kontrolluese
9789951000277

Printimi i ISBN-së në Bookland EAN

SI MUND TA SIGURONI BARKODIN PËR LIBRIN TUAJ?

Ju e keni përfunduar librin tuaj dhe tashmë e keni bërë të gatshëm për ta dërguar në shtyp. Papritmas ju bie ndërmend se ju duhet edhe barkodi. Kështu së pari duhet të siguroni ISBN (International Standard Book Number) për librin tuaj. Këtë mund ta bëni duke iu drejtuar Agjencisë Kombëtare të ISBN-së e cila funksionon në kuadër të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare. Pasi e keni siguruar ISBN-në, hapi tjetër është sigurimi i barkodit për ISBN-në e librit tuaj. Që nga 1 dhjetori i vitit 2010, Agjencia Kombëtare e ISBN-së me seli në BKUK ka filluar të bëjë konvertimin e ISBN-së në barkod për secilin botues dhe për secilin titull që paraqitet për marrjen e ISBN-së pa dallim. Ky shërbim që po bën Zyra e ISBN-së nuk do të jetë i përhershëm. Prandaj botuesit në Kosovë, qofshi botues privat, institucione apo autorë botues, duhet të përgatitën që, në të ardhmen, ta bëjnë vetë gjenerimin e ISBN-së në barkod për librat e tyre! Kur ju keni shpenzuar shumë para në përgatitjen dhe shtypjen e librit tuaj, është e rëndësishme të mos kurseni për sigurimin e barkodit! Softuerët që përdoren për konvertimin e ISBN-së në barkod nuk janë të shtrenjtë dhe janë të dizajnuar posaçërisht për të krijuar imazhe të barkodit. Shumica e librarive sot kanë sisteme elektronike të shitjes të cilët mundësojnë menaxhim modern dhe shumë komod me stoqet e librave në saje të përdorimit të barkodit.

KATALOGIMI ELEKTRONIK I BOTIMEVE NË SERI

Bibliotekat sot përballen me sfidën e përpunimit dhe të klasifikimit në një invazion të fuqishëm botimesh, përmbajtje fushash lëndore dhe informacion të shumëllojshëm, i cili po zgjerohet me shpejtësi. Nevoja dhe kërkesa e përdoruesve për qasje të shpejtë dhe të lehtë në informacione relevante, ka hapur debatin e madh në komunitetin bibliotekar se si të ndërtohen strategji dhe vizione në lidhje me dhënien e informacionit dhe menaxhimin e tij në bibliotekat bashkëkohore.

Meqë bibliotekat tashmë nuk janë vetëm hapësira fizike të mbushura plot me materiale bibliotekare të përpunuara, por edhe mjedise të të dhënave elektronike dhe digjitale të informacionit, është një sfidë e rëndësishme për kataloguesit se si do t'i qasen përpunimit dhe klasifikimit të materialit bibliotekar, duke pasur parasysh kërkimin nga ana e përdoruesit të të njëjtit material bibliotekar i konvertuar në të dhëna virtuale; teknologjitë e reja vijojnë në mënyrë dramatike të ndikojnë ditë për ditë në sistemin dhe qasjen tonë ndaj informacionit dhe komunikimit.

Në këtë konstelacion zhvillimesh të shpejta, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, me implementimin e Programit bibliotekar Alpeh 500, është duke bërë përpjekje të përcjellë dhe implementojë ndryshimet dhe transformimet nëpër të cilat po kalon përpunimi dhe menaxhimi i informacionit bibliotekar.

Meqë nëpërmjet sistemit bibliotekave Aleph 500, i implementuar në BKUK, mund të sigurohet kërkimi i informacionit bibliotekar në çdo kohë dhe nga çdo vend, duke plotësuar kërkesat në rritje të përdoruesve për këtë formë të kërkimit, stafi i bibliotekës, i cili është i angazhuar në procesin e katalogimit të njësive bibliotekare, po përcjell me kujdes një sërë standardesh ndërkombëtare gjatë punës së saj të përditshme, sidomos në fushat e përpunimit të materialeve bibliotekare.

Pra, meqë nëpërmjet katalogimit mundësohet përshkrimi bibliografik i materialeve në çfarëdo formati, stafi në Departamentin e Katalogimit është duke përcjell me interesim dhe vijueshëm, format elektronike të ruajtjes së të dhënave në formatin MARC 21, standard në të cilin gjejnë zbatim rregullat e katalogimit, dhe si të tilla mund të kuptohen dhe manipulohen nga teknologjia kompjuterike. Për këtë, stafi i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, përcjell dhe përdor me kujdes veçanërisht dy standarde ndërkombëtare të katalogimit: AACR2 - standard i derivuar nga ISBD, i detajuar për të përshtatur burimet elektronike, si dhe ISBD - standard i krijuar nga IFLA i përdorur gjerësisht në bibliotekat e mbarë botës.

Në këtë kontekst, fokusimi në rregullat e botimeve serike, kur është fjala te përpunimi i gazetave, revistave, buletineve, e materialeve të tjera në botim serik, përqendron vëmendjen dhe dilemën tonë, kur ajo ekziston, që të mendojmë lidhur me llojin e botimit, ku ta vendosim dhe si ta trajtojnë burimin që katalogohet.

Botimi mund të jetë 'i përcaktuar' d.m.th. i tërësishëm (si vëllim i vetëm monografik), si monografi e shumëpjesshme, ose mund jetë i botuar në mënyrë suksesive. Seria është një shembull i burimit të vazhdueshëm. Njësia themelore që duhet të katalogohet, referohet tani si 'burim bibliografik', pra si një artikull që formon bazën për përshkrim bibliografik.

Definicioni i serive ishte rishikuar në vitin 2002, për t'u definuar si "burim elektronik i suksesshëm i pjesëve diskrete, zakonisht që mban numërimin që nuk ka konkluzion të parapërcaktuar". Kështu pra, seritë kanë dy veçori te njohura: ato janë pjesë që mund të qëndrojnë vetëm dhe nuk kanë konkluzion të parapërcaktuar.

Rregullat dhe parimet kryesore që udhëheqin shënimin kryesor dhe shënimet e shtuara janë të njëjta si për monografitë. Këto rregulla mbulohen nga AACR2 (Anglo-American Cataloging Records, ose sipas AACR2 dhe ISDS, botimi në seri përkufizohet si një botim i çdo lloji që del në pjesë të njëpasnjëshme, të cilat kanë tregues numerik ose kronologjik dhe që parashikohet të kenë vazhdimësi të pacaktuar.

Termi 'seri', i referohet pronës së brendshme të një serie - pra, radhës së tij. Në literaturë, termi është përdorur si një emër për t'iu referuar një formati (brenda një gjinie) me të cilën një histori (zakonisht kronologjike), është dhënë në pjesë vijuese të një botimi periodik të vetëm. Veçori kryesore e tyre është dalja me intervale në kohë të caktuar ose të pacaktuar me numra, pjesë me datën përkatëse. Të gjithë numrat e një serie kanë zakonisht titull të njëjtë, dhe të njëjtën formë e madhësi.

Përshkrimi i botimeve në seri përbëhet nga dy pjesë: pjesa e përgjithshme dhe specifikimi. Pjesa e përgjithshme përmban të dhëna të përgjithshme për të gjithë ose shumicën e numrave,

ndërsa specifikimi përmban të dhëna që karakterizojnë numra të veçantë.

Para se të fillohet me katalogimin e një serie (reviste, gazete, buletini, vjetari etj.), duhet që në detaje ta shohim se me çka ka të bëjë ai material, ndërsa që faqja e katalogimin na jep mundësinë që në detaje t'i fusim në program të gjitha veçoritë që e karakterizojnë atë material.

Duke filluar nga fusha 008, e cila në vete përmban një dritare tjetër të përbërë nga 0-39 nënfusha, si të tilla janë data e futur në fajll, vendi i botimit, periodiciteti, rregullsia, lloji i burimit të vazhdueshëm, forma e ekzemplarit, lloji i botimit (mund të jetë qeveritar ose konferencash), alfabeti dhe shkrimi origjinal i titullit, dhe a është njësi e modifikuar (a është kthyer nga ndonjë gjuhë tjetwr p.sh. nga latinishtja në shqip).

Tagu 022-është tagu i ISSN-së, pra ID ndërkombëtare e burimit të vazhdueshëm. ISSN-ja është një numër ndërkombëtar që u jepet botimeve në seri për identifikimin e tyre, ashtu si dhe ISBN-ja për librat. ISSN-ja përbëhet nga tetë shifra të ndara në dy grupe me një vijë në mes. Shtatë shifrat e para përfaqësojnë numrin rendor dhe shifra e fundit është e kontrollit. Kur ISSN-ja shoqërohet dhe me shenja të tjera, përshkruhet ashtu siç është dhënë në botim. P.sh.: ISSN 0135-6097; LP ISSN 0421-0760.

Tagu 041 është pjesa ku shkruhet gjuha që është përdorur në katalogim të njësisë. Në fushën 080, përshkruhet KUD-i, ndërsa në nënfushën x, përshkruhet kodin e vendit, të cilin e gjejmë përmes listës se formatit MARC 21.

Zona e titullit dhe autorit

Kjo zonë përmban të dhëna kryesore për botimin së seri të domosdoshme për identifikimin e tij. Në të bëjnë pjesë: titulli, tipi i materialit, titulli paralel, nëntitulli, si dhe të dhëna për persona dhe institucione që kanë marrë pjesë në përgatitjen e botimit. Elementi i parë i përshkrimit është titulli. Titulli vendoset në fushën 245. Ky është i dallueshëm nga shtypi (madhësia e germave) ose ngjyrat e përdorura, p. sh.: Iliria.

Titulli mund të përbëhet nga një fjalë, një fjali, disa fjalë ose fjali të lidhura gramatikisht midis tyre. Titulli karakterizon botimin duke pasqyruar tematikën e tij, p. sh.: Ekonomia; Mjekësia etj.

Kur titulli është dhënë në dy forma: në formë të plotë dhe me iniciale ose me shkurtime, në përshkrim zgjidhet forma e plotë. Nëse forma e plotë nuk është e dhënë në burimin e informacionit, titulli përshkruhet sipas formës së shkurtuar, p. sh.: Key abstracts. Industrial power and control systems; Études et documents tchadiens. Serie B.

Titulli paralel

Ky titull vendoset në përshkrim vetëm kur është në fletën e titullit dhe paraprihet me barazim, p. sh.: Bank of Canada review= Revue de la Banque du Canda.

Në nëntitull vendosen të dhëna që plotësojnë titullin sipas rregullit të përgjithshëm. Të dhëna për organizatën ose institucionin botues vendosen në nëntitull kur këto janë të lidhura gramatikisht me të dhënat për llojin e botimit, tematikën, etj., p. sh.: Iliria: revistë arkeologjike; Buletini nafta dhe gazi: organ shkencor i Institutit Gjeologjik të Naftës.

Zona e botimit

Këtu përshkruhen veçori të botimit, si: të dhëna për botim lokal; të dhëna për interesa të veçanta të botimit; të dhëna për format ose formë fizike të veçantë; të dhëna për gjuhën; të dhëna për rishtypje ose ribotim.

Zona e të dhënave numerike, alfabetike, kronologjike

Kjo zonë përdoret për botime në seri dhe për disa tipa të tjera materialesh. Të dhënat paraprihen me pikë, hapësirë, vijë, hapësirë. Zona përmban të dhëna për numrin e parë të serialit e shprehur me numër, germë, datë, e cila pasohet me vijë që tregon vazhdimësi, p. sh.: Nr. 1; V. 1, nr. 1; V. 1 nr. 1 (1971); V. 5, nr. 12 (1975).

Zona e vendit të botimit, botuesit dhe datës

Vendi dhe botuesi vendosen në përshkrim sipas rregullit të përgjithshëm, p. sh.: Tiranë: Shkenca, 1981; Montreal: The Association, 1968.

Zona e serisë

Kjo zonë përdoret kur të gjithë numrat i përkasin të njëjtës seri ose nënseri, p. sh.: Etnografia shqiptare - Nr. 1 (1962) - 25 cm. - (Inst. i Historisë dhe Gjuhësisë. Sekt. i Etnografisë). Në vazhdim të titullit të serisë vendoset ISSN-ja e saj si dhe numra të tjerë, kur janë të njëjtë në të gjithë numrat, p. sh.: (Public Health Service Publication ; No. 1124); (West Virginia University Bulletin, ISSN 0083-8640).

Zona e shënimeve

Në shënime vendosen të dhëna të nevojshme që nuk janë vendosur në zonat e mëparshme. Të tilla janë të dhënat për ndryshimin e titullit, për periodicitetin, për ndërprerjen e botimit, gjuhën e tekstit, shënime bibliografike, indekse etj.

Pra, erdhëm deri këtu, për të dhënë vetëm disa nga pikat kryesore të katalogimit të njësive bibliografike të burimit të vazhdueshëm, pra serive. Në përfundim, theksojmë se përpunimi i mbështetur qartë mbi rregulla dhe standarde ndërkombëtare të katalogimit, bën të mundur sigurimin e një zgjidhjeje të saktë për menaxhimin e spektrit të plotë të materialeve të bibliotekës e, në këtë kontekst, në veçanti të materialeve të burimeve të vazhdueshme që mund të përdoren mbi një bazë më vete ose si pjesë e një sistemi të integruar.

Përgatiti: Zahide Krapi

SFIDAT E ARSIMIMIT BIBLIOTEKAR NË EPOKËN E INFORMACIONIT

MR. AVDI LAKNA

Ndryshimet e mëdha që vijnë nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe i komunikimit, si dhe globalizimi, kanë detyruar institucionet, duke përfshirë edhe bibliotekat, të shqyrtojnë perspektivën e zhvillimit të tyre.

Në këtë kontekst, është në sprovë edhe roli i bibliotekarisë dhe bibliotekave, si mbrojtëse e trashëgimisë nacionale dhe botërore. Bibliotekat po bëjnë përpjekje për të përshtatur funksionin dhe qasjen e tyre në materialet bibliotekare - sasinë dhe cilësinë e këtyre materialeve, format e ndryshme të ruajtjes, përderisa përdoruesit i mbetet të socializohet me trendet e reja të qasjes në informacionin dhe materialin bibliotekar.

I.

Institucionet, si: UNESCO, IFLA, EBLIDA etj., bibliotekat i perceptojnë si institucione sociale, që ndihmojnë qytetarët në arsimim, zhvillim kulturor dhe informacion; ato shërbejnë edhe si vende të akcesit publik në rrjet, vend ku grumbullohen komunitetet. Njëra prej detyrave të bibliotekave është forcimi i kohezionit social e arsimor, duke ndihmuar në edukimin dhe ngritjen e vetëdijes aktive qytetare, zhvillimin ekonomik, të mësuarit dhe krijimin e njohurive të reja kërkimore-shkencore dhe si shtytëse themelore për mësim gjatë gjithë jetës.

Me futjen e konceptit *mësimi gjatë gjithë jetës*, i cili është paraqitur në strategjinë e Lisabonës në vitin 2000, me qëllim lehtësimin e arsimimit dhe përgatitjen e kuadrit profesional për tregun e punës në Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, biblioteka ka zgjeruar përmbajtjen dhe fushat aktivitetit të vet, për të qenë kompatibile me këto



zhvillime. Implementimi i këtyre ndryshimeve, do të duhej të zbatohej nëpërmjet ekspertëve të shkolluar në shkencat e bibliotekarisë dhe informacionit. Nuk është për t'u habitur që shkollimi i bibliotekarëve dhe specializimi i përhershëm i tyre, në dekadën e fundit në Evropë po trajtohet me shumë seriozitet. Kjo reformë është e lidhur me Deklaratën e Bolonjës, dokument i cili është përgatitur në vitin 1999. Në këtë kontekst, Shoqata Evropiane për Biblioteka, Informacion, Arsim dhe Kërkimit (EUCLID) menjëherë pas miratimit të Deklaratës së Bolonjës, ka organizuar disa takime profesionale të cilat i kushtohen arsimit të bibliotekarëve, si ajo në Selanik (2002) dhe Potsdam (2003). Ndërsa Shoqata Evropiane e Bibliotekave Informacioneve dhe Dokumenteve (EBLIDA), në bashkëpunim me Shoqatën e Bibliotekarëve Portugez, organizuan një takim profesional për edukimin formal të bibliotekarëve (*Librarian @ educating for the future, Lisabon, 2007*). Për studimet bibliotekare në Evropë ishte e rëndësishme edhe projekti i Mbretërisë Daneze për shkollim, ku u përgatit edhe Kurrikula Evropiane, program i shkencës dhe informacionit, i cili është financuar nga Bashkimi Evropian në kuadrin e programit Sokrati 2005. Në hartimin e programit mësimor kanë marrë pjesë qindra profesionistë nga bibliotekat e vendeve anëtare dhe vende të tjera evropiane. Ky projekt është botuar si një libër elektronik: Programi - Kurrikula Europiane, 2005, Kajberg, 2007. Në këtë takim ekspertët e bibliotekave në parim u pajtuan për lëndët bazë të bibliotekarisë, por ishte e vështirë për-

shtatja e kurrikulit për studimet bibliotekare në planin e tyre pesëvjeçar, për shkak të dallimit në studimet akademike, për profilet e ekspertëve që studiojnë në vende të ndryshme. Si rezultat i këtyre pengesave, në disa vende evropiane në zhvillimin e studimeve të bibliotekarisë ka ndikuar vetë themeluesi, i cili përgatit edhe programin e studimeve. Studimet nga shkencat e bibliotekarisë organizohen në fakultetet e shkencave humane, shkencave shoqërore, menaxhmentit, në shkencat e informatikës apo në fakultetet e gazetarisë dhe komunikimit.

Nga hulumtimet e bëra, konkluzioni përfundimtar ka qenë, se nuk është e mundur realizimi i një programi të përbashkët dhe i standardizuar i studimeve nga shkencat e bibliotekarisë për të gjitha vendet evropiane. Krahasimi dhe vlerësimi i kualifikimeve bibliotekare është i një rëndësie të veçantë për IFLA-n, si organizatë qendrore e bibliotekarisë botërore, e kjo na bën me dije se IFLA është angazhuar seriozisht në përgatitjen e projektit ndërkombëtar, me të cilin mendohet të arrihen kualitete të baraspeshuara të kualifikimeve bibliotekare, si dhe parashtrimin e programeve kualitative për studiuesit e kësaj fushe. Në fakt, në disa vende në nivel kombëtar ka një organ i cili vlerëson përshtatshmërinë e programeve dhe e bënë akreditimin e tyre, por në shumicën e vendeve nuk ekziston një organ i tillë, që do të thotë se procesi i sigurimit të kualitetit nuk është i mbikëqyrur. Ndërsa në SHBA, Britani të Madhe, Australi dhe në disa vende të tjera akreditimin e bëjnë shoqatat bibliotekare.

II.

Të mësuarit gjatë gjithë jetës është një koncept që komuniteti bibliotekar relativisht lehtë e kuptoi dhe pranoi. Në kontekstin tonë, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, përveç organizimit të trajnimeve, të kohëpaskohshme, për bibliotekarë të institucioneve të ndryshme, ka arritur të plotësojë një boshllëk edhe nëpërmjet organizmit të përbashkët me Ambasadën Amerikane në Prishtinë të Javës së Bibliotekës në Kosovë, çdo vit, gjatë së cilës trajtohen probleme të rëndësime nga fusha e bibliotekarisë nga ekspertë të huaj dhe vendës. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm në planin nacional është edhe organizimi, çdo vit, i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, ku arrihet të diskutohen probleme me interes të të dy vendeve në fushë të bibliotekarisë. Në këtë kontekst, në funksion të arsimimit të stafit bibliotekar, vlen të përmendet edhe specializimi në Amerikë i një grupi të bibliotekarëve nga Kosova, me përkrahjen e Ambasadës së ShBA-ve në Prishtinë. Po ashtu, nga një marrëveshje ndëruniversitare, e nënshkruar në vitin 2007, mes disa universiteteve, ku bën pjesë edhe Universiteti i Prishtinës, një grup i bibliotekarëve nga Kosova kanë vijuar studimet pasuniversitare pa shkëputje nga puna në Universitetin e Zarës.

Duhet thënë se arsimimi i vazhdueshëm i stafit bibliotekar, në aspektin financiar, është i kushtueshëm për shtetin, por është shumë i nevojshëm; ky investim duhet të dëshmohet se është i dobishëm, duke ofruar shërbime të avancuara profesionale në biblioteka. Qëllimi është përfitimi i shkathtësive profesionale, e më këtë do të mundësohej edhe ofrimi i shërbimeve kualitative. Bibliotekaria te ne e meriton një trajtim më të mirë. Në mungesë të fakultetit dhe shkollave profesionale nga shkencat e bibliotekarisë, kjo barrë i ka mbetur Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në kuadër të saj, përgjegjësi të veçantë ka Departamenti i Arsimimit Bibliotekar. Ky Departament ka nevojë të përkrahet në aspektin material dhe profesional, duke pasur për mision parësor arsimimin dhe avancimin profesional të bibliotekarëve të Kosovës.

Fillimisht, para se të kemi ndërmarrje të mëdha për themelimin e fakultetit të bibliotekarisë në Kosovë, duhet të kemi kuadrin profesional të përgatitur. Derisa kjo të bëhet, na duhet që të krijojmë një infrastrukturë që mundëson arritjen e këtij objektivi, duke pasur parasysh nga format e motivimit për përgatitjen e shkollimin e kuadrit e deri te organizimi i brendshëm i bibliotekave. Bibliotekarët do të duhej të plotësojnë dijet e tyre me të arriturat e reja në mënyrë që të mund të përshtaten me trendët nëpër të cilat po kalon zhvillimi i bibliotekave në epokën moderne të informacionit e të komunikimit.

Në këtë kontekst, bartës i shumë iniciativave do të jetë Departamenti për Arsimim Bibliotekar, i cili është në kuadër të BKUK-së, ndërsa që ky Departament, përveç përkrahjes nga BKUK, duhet ta ketë edhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe nga Shoqata e Bibliotekarëve e Kosovës, si një organ promotor në përkrahje të bibliotekave.

Pra, duhet të krijojmë parakushte në mënyrë që të mos humbet hapi në këto zhvillime, duke dhënë kontributin e tyre të gjitha institucionet relevante të cilat kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për zhvillimet që janë të lidhura me fusha të veprimtarisë bibliotekare.

BIBLIOTEKAT E VEÇANTA NË BKUK

ALBANË MEHMETAJ

Bibliotekat e veçanta, përfshirë bibliotekat legatë, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, janë qendra të informacionit dhe të materialeve bibliotekare me përmbajtje të profilizuar për një tip të veçantë të përdoruesve. Pra, ato janë zhvilluar për të mbështetur misione të veçanta të kulturës e të dijes dhe koleksionet e shërbimet e tyre janë më në shënjestër për probleme specifike dhe për përdorues me interesime të veçanta.

Këto biblioteka janë themeluar gjatë dhjetëvjetëshit të fundit dhe paraqesin kulturën dhe frymën e re të këtij institucioni, kulturë e cila e lidh BKUK-në, edhe në një rrafsh, me bibliotekat bashkëkohore të vendeve në rajon dhe më gjerë.

Bibliotekat e veçanta në BKUK janë tematike, të autorëve, të vendeve e të fushave të artit. Secila nga ato ka rëndësi të veçantë dhe shërben, jo vetëm për të arkivuar kujtesën kulturore, por, në radhë të parë, për të informuar e për të ndihmuar studentët, studiuesit dhe të gjithë të interesuarit për fushat të cilat përfaqësohen në këto biblioteka.

Pra, bibliotekat e veçanta të BKUK-së, përpos funksionit universal, si të gjitha bibliotekat e këtij tipi, kanë funksione që i përcakton gjithashtu qëllimi, koha e vendi në të cilin janë themeluar.

I.

Biblioteka e Këndit Amerikan, është këndi në të cilin ruhen e përpunohen materiale bibliotekare që janë pjesë e historisë, kulturës, jetës e demokracisë amerikane. Ky kënd është një udhërrëfyes për të kërkuar më tej, nëpërmjet literaturës e formave të tjera të materialit bibliotekar, njohjen me një vend të madh e të fuqishëm të dijeve e të kulturës, si dhe të një jete polike demokratike që ndiqet si shembull nga vendet me kulturë e demokraci të zhvilluar.

Këndi Amerikan në Prishtinë është hapur më 20 nëntor 2003, si pjesë e partneritetit ndërmjet atëherë ish-Zyrës për Marrëdhënie Publike të Zyrës Amerikane në Prishtinë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Koleksioni i këtij këndi përfshin libra, revista dhe DVD për Amerikën në gjuhën angleze, si dhe atë shqipe. Në baza vjetore këndi organizon ngjarje siç janë ligjërata, prezantime, ekspozita, orët për videofilma, diskutimet etj.

Këndi Amerikan në Prishtinë është një vendtakim i kulturës amerikane me atë kosovare dhe është i hapur për të gjithë përdoruesit.

Një shërbim tjetër me vlerë i këndit është qasja në internet për kërkime arsimore.

Në Bibliotekën e Këndit Amerikan janë 2202 njësi bibliografike dhe fizike të përpunuara në programin e automatizuar bibliotekar ALEPH500, 340 njësi bibliografike dhe fizike të papërpunuara në programin e automatizuar bibliotekar ALEPH500, 304 libra në huazim, si dhe 315 DVD dhe videokaseta.

Depozitura e Bibliotekës së NATO-s mundëson qasje në dokumentacionin e kësaj organizate shumë të rëndësishme ushtarake në botën moderne. Ajo është themeluar që nga prilli i viti 2005, në kuadër të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Në të përfshihen tituj të ndryshëm të librave dhe periodikëve që kanë të bëjnë më punën, organizimin, misionet, ndërhyrjet ushtarake, takimet etj. të NATOS-s.

Kjo depoziturë kohë pas kohe pajiset me literaturë dhe botime të reja.

Depozitura e NATO-s ofron një ambient shumë të përshtatshëm dhe shumë komod për lexuesit. Kjo depozitur mundëson qasje të barabartë në botimet e NATO-s, pra pjesa më e madhe e dokumenteve, librave, revistave, manualeve, katalogëve, që aktualisht e përbëjnë këtë fond, rrjedhin nga shërbimi i botimeve të NATO-s.

Biblioteka europiane është themeluar në dhjetor të viti 2007. Ka afërsish 3000 njësi, kryesisht në gjuhën angleze dhe në atë gjermane.

Njësitë janë të fushë së sociologjisë, shkencave politike, drejtësisë, historisë dhe të letërsisë evropiane.

Koleksioni është iëson edhe huazimin e librit. Studentët që shfrytëzojnë literaturën e kësaj biblioteke janë kryesisht studentë, studentë të shkallës master dhe të doktoraturës.

Kjo bibliotekë përmbush nevojën për literaturë europiane. Po ashtu, mundëson që, edhe nëse nuk gjendet ndonjë libër në BKUK, ose në rrjetin

e bibliotekave të Kosovës, të sillet këtu nëpërmjet huazimit.

Biblioteka europiane bashkëpunon me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Europian në Kosovë.

Kjo bibliotekë nxjerr revistën "Europa", të cilën e shpërndan falas.

Biblioteka e Artit Bashkëkohor sjell të dhëna, vepra arti e teori që lidhen me trendët moderne të artit. Aty mund të informohesh, të njihesh me vepra të rëndësishme të kulturës botërore, t'i studiosh ato, por edhe të marrësh mendimin për to.

Biblioteka e Artit Bashkëkohor është hapur më 2009 dhe përbëhet nga 6000 tituj librash që u takojnë arteve bashkëkohore. Librat janë në gjuhën gjermane, angleze, italiane dhe franceze.

Përpos librave, në këtë bibliotekë ka edhe gazeta e periodikë, katalogë ekspozitash, dorëshkrime, korrespondenca CD, fotografi, harta etj.

II.

Fondet e bibliotekave legatë të BKUK-së janë pjesë e rëndësishme e kujtesës kombëtare. Këto biblioteka përbëjnë një shenjë përkushtimi për autorë nacionalë. Ato kanë historinë dhe ekzistencën e tyre të veçantë që dëftojnë jo vetëm veprimtarinë krijuese, por edhe referencat hulumtuese e shkencore të këtyre autorëve.

Biblioteka e Krist Malokit, është njëra prej bibliotekave legatë që ruan e zbulon për të gjithë përdoruesit literaturën e pëlqyer e të përdorur nga ky autor i madh gjatë gjithë jetës. Kjo bibliotekë, gjithashtu, reflekton edhe kulturën kombëtare, duke pasur parasysh se Krist Maloki është një autor i rëndësishëm shqiptar, vepra e të cilit jep shpirtin, traditën e modernitetin shqiptar.

Biblioteka e Fehmi Aganit

Biblioteka e Krist Malokit përbëhet nga libra dhe revista. Dominojnë librat në gjuhën shqipe dhe atë gjermane. Më shumë ka libra letrarë e kuturorë, pastaj libra historikë dhe politikë. Janë 398 tituj të librave dhe 56 tituj të revistave.

Kjo bibliotekë përmban revistat e njohura: "Leka", "Kalendari kombiar", "Hylli i Dritës", "Përpjekja shqiptare", "Fryma", "Jeta e Re", "Dituria", "Ballkan studies" etj.

Biblioteka e Fehmi Aganit, si edhe vepra e këtij autori e veprimtari të njohur, është dëshmi për një kohë kulturore e politike të shqiptarëve në Kosovë e të shqiptarëve përgjithësisht. Është thënë shpesh se kultura e një kohe përfaqësohet me kulturën e njerëzve të zgjedhur të saj.

Biblioteka e Fehmi Aganit, është themeluar në vitin 2002 dhe ka 2075 tituj librash, si dhe 68 tituj revistash, me 839 njësi.

Pjesë e kësaj biblioteke është edhe vepra komplete e Fehmi Aganit. Ai është autor i librave: "Në rrjedha të mendimit sociologjik", "Për shoqërinë civile", "Demokracia, kombi, vetëvendosja", "Partitë dhe grupet politike në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore", "Sindikatat gjermane dhe shkrime të tjera", "Gjuha e dhunës dhe zëri i arsyes", "Pavarësia, gjasa dhe shpresa".

Përfundim

Mund të themi se të gjitha këto biblioteka kanë hapësirat e leximit dhe literatura e këtyre bibliotekave vihet në dispozicion të lexuesve çdo ditë.

Kjo trashëgimi e çmuar, që përmbajnë këto biblioteka, është arsyeja e themelimit dhe e ruajtjes së prestigjit të tyre.

Sasia dhe cilësia e fondit të këtyre bibliotekave, i bëjnë ato të rëndësishme dhe me interes për përdoruesin tonë, në kuadrin e sistemit të fushave të veçanta të koleksionimit dhe të fondit të saj të shumëllojshëm dhe të pasur.

Pra, bibliotekat e veçanta i japin BKUK-së pamjen e një mozaiku, në të cilin ruhen e ofrohen për t'u njohur dimensione të veçanta të kulturës universale dhe të asaj kombëtare shqiptare.

E ARDHMJA E LIBRIT DHE BIBLIOTEKAVE - REFLEKSIONE DHE MENDIME

REUBEN MUSIKER

Ky artikull është rezultat i debateve të vazhdueshme prej më shumë se gjysmëshekulli për pushtetin në mes të librave të shtypur dhe atyre elektronikë. Fokusohet veçanërisht të rëndësia e bibliotekave, gjithnjë përcjellë me informacione profesionale.

Në agimin e një shekulli të ri dhe si për koincidencë edhe në agim të mileniumit të ri, ofrohet mundësia për të ripohuar forcën e autorit dhe besimin në të, gjë që mund ta dëshmojë me përvojën prej me pak se gjysmëshekulli si bibliotekar, se librat e shtypur do të mbijetojnë në të ardhmen e parashikueshme.

Shumë vjet më parë, gjatë zhvillimit të Konferencës së Bibliofilisë në Johanesburg të Afrikës së Jugut, unë shfrytëzova rastin për të ripohuar besimin tim në të ardhmen e librit të shtypur. Për të bërë këtë isha i inspiruar nga veprimi i Bibliotekës së Kongresit në ShBA që kishte bërë me themelimin e Qendrës për Librin dhe në afirmimin që kjo qendër bënte për rëndësinë e fjalës dhe librit të shtypur.

Të dyja këto veprime, pra besimi im në librin e shtypur dhe besimi në atë që proklamonte Qendra për Librin, kishin për qëllim mbështetjen në ndihmën shpirtërore, nacionale, fizike dhe financiare që amerikanët bënin për Librin.

Më vonë, një Qendër për Librin u themelua edhe në Cape Town, në një ndërtesë dikur formalisht e "pushtuar" nga arkivi i vendit, kjo në thelb është një komponentë e Bibliotekës së Afrikës se Jugut, njëra nga dy bibliotekat kombëtare sa ka vendi, gjë që tregon se kjo është vetëm një mënyrë jetese e librit, pra pjesa që nuk ofron kufijtë ndarës midis një biblioteke kombëtare nga një qendre për ruajtjen e librit.

Prandaj veprimi mbi ripohimin e konceptit për librin e shtypur është i nevojshëm kohë pas kohe, sepse librat kanë qenë gjithmonë të diskutueshme.

Kjo padyshim ka qenë një temë e diskutueshme prej gati 500 vjetësh, që nga Gutenbergu, por atëherë diskutimi zhvillohej kryesisht për arsye të përmbajtjes së tyre. Dikush duhet vetëm të mendojë në emrat, si: Galileo, Voltaire, Darwin dhe Marx, për të kuptuar që idetë e dala nga këto libra tronditen kisha, rrezuan monarki dhe përhapen revolucione.

Libri gjithmonë ishte dhe është një metodë e fuqishme që përcjell ndryshime në shoqëri.

SFIDAT TEKNOLOGJIKE DHE KONKURRENCA

Jo vetëm ne si qenie njerëzore e hetojmë lëvizjen nga një fundshekull te një fillimshekull, por edhe bota në përgjithësi përballët me mënyra të llojllojshme ndryshimi, dhe njëra nga to është: *forma e fjalës së shtypur*.

Tendencat e televizionit dhe kompjuterit janë dy shembuj të fuqishëm të pajisjeve teknologjike, të cilat vazhdojnë të paraqesin sfidë për librat, botuesit dhe bibliotekat, për me tepër kur dihet që videokasetat me incizime në njërën anë dhe kompjuterët në anën tjetër kanë sjellë me vete edhe hapje për horizonte të reja për individët, pra për përdoruesit e tyre.

Kombinimi i kompjuterëve dhe televizionit ka sjellë me vete rivalë dhe konkurrentë ndaj faqe të shtypura, për shkak të qasjes fleksibile dhe shpejtësisë së shfaqjes së tekstit në ekran, që janë karakteristika të qenësishme të kësaj teknologjie moderne.

Video-disqet kompjuterike kanë mundësi për ruajtjen e përmbajtjes së mijëra librave në një sferë të hollë plastike. CD Rom-et janë një e ardhme e stabilizuar e zhvillimit teknologjik. Strukturimi i televizioneve mundëson ofrimin e miliona faqeve tekst, që mund të shpërndahet lehtësisht nga baza e të dhënave në pjesë të ndryshme të botës.

Prandaj është fakt i pamohueshëm që kompjuterët dhe satelitët janë të përfshirë në realizimin e mesazheve tekstuale dhe që, pa marrë parasysh gjithë specifikat veç e veç që mund të burojnë nga to, prapë se prapë këto përbëjnë një kërcënim për shtypin tradicional në përgjithësi dhe për librin në veçanti. Megjithatë, deri më tani mund të themi se rezultati përfundimtar nuk është gjithmonë aq revolucionar apo edhe aq i ndryshueshëm sa ndokush mund ta mendojë. Për shembull në industrinë botuese, teknologjia elektronike ka zëvendësuar tipin e realizimit të proceseve me punë dore, mirëpo ende produkti është i njëjti, objekti i shtypur, pa marrë parasysh se a kemi të bëjmë me gazeta, revista apo libra.

Megjithëkëtë e dimë që kompjuterët tani janë pjesë përbërëse e veprimtarisë botuese deri në atë masë sa autorët paraqesin doreshkrimet e tyre në disqe kompjuteri.

UTOPIA E BOTIMEVE ELEKTRONIKE

Nuk është e vështirë të spekulohet mbi atë se çfarë mund të ndodhë nëse kjo situatë shkon deri në ekstrem.

Nëse editimi, redaktimi dhe përgatitja e një dorëshkrimi për botim, qoftë në përbërjen dhe krijimin e një imazhi të tekstit, qoftë në printimin, marketingun dhe shpërndarjen e librave mund të trajtohen në mënyrë elektronike përmes kompjuterëve, në fund të gjithë kësaj, rezultati do të jetë publikimi i menjëhershëm.

Logjikisht nëse gjithë puna që u tha më lartë transformohet në kushtet që vazhdimisht po proklamohet se do të jenë funksionale në një të ardhme të afërt, kjo situatë mund të vazhdojë përmes punës se autorëve, publikuesve dhe lexuesve dhe komunikimit me njëri-tjetrin me një mundim dhe kosto me të vogël, sepse nuk do të ketë nevojë për botues, radhitës, printerë, organizata marketingu dhe dyqane të librit, siç i njohim ne sot. Madje edhe vlerësimi edhe "pushteti" mbi fjalën e shkruar ose librin mund të ekzekutohet me prekjen e një butoni.

Një artikull mund të dorëzohet në një redaksi të një reviste elektronike në formë elektronike dhe prezenca e vendimmarrësit për publikim ose jo do të ekzekutohen në formë elektronike!

Rezultati përfundimtar i gjithë kësaj është i mahnitshëm nëse e mendojmë përcjelljen e informacionit në miliarda faqe me çmim me të vogël, por me shpejtësi të madhe.

Mediat kanë publikuar edhe shumë karakteristika që do të jenë shenjë dallueshmërie e librit elektronik në të ardhmen.

RËNDËSIA E BOTUESVE DHE E LEXUESVE

Megjithatë, është e rëndësishme që t'ia kujtojmë vetvetes se e gjithë kjo teknologji ekzistuese nuk mund të ndryshojë disa aspekte themelore që e përbëjnë botën e librit.

Roli thelbësor i botuesit është të vendosë se çfarë të botojë dhe si të përfitojë audiencë të pasur. Vendi që ai zë në mes të autorit dhe lexuesit, e bën



botuesin autoritet të rëndësishëm në realizimin e procesit të përzgjedhjes.

A mundt dikush me të vërtetë t'i lejojë vetes që të sakrifikojë gjithë ato shenja që e bëjnë të veçantë në botimin e librit: përmasat e faqeve, mënyra e përzgjedhjes, shenja identifikuese e botuesit (logo), veçantia e faqosjes që e identifikon secilin botues, dizajnimi i kopertinës; dhe të gjitha ato që i garantojnë respektin një botuesi? Rëndësia e lexuesve në botën e librave nuk duhet të jetë e nënvlerësuar, sepse ata nuk mund të privohen nga vendimet se çfarë të lexojnë dhe se çfarë të blejnë.

Çështja është që lexuesit e gjejnë rrugën për të dërguar mesazhet e tyre te botuesit: interesimi gjatë prezantimeve televizive, prezencën në prezantimet si rrjedhojë e reklamës ose edhe kërkesat në përzgjedhje për ta përmbushur kohën e lirë dhe shumë rezultate të tjera që mund të lidhen, me filmin, teatrin, koncertet e të tjera aktivitete kulturore, që dalin si rezultat i librit dhe inskenimit të tij/tyre. Dhe, e gjithë kjo është dëshmi që librat janë pasqyrë e zhvillimeve shoqërore. Prandaj, është e sigurt të them se e ardhmja e librit varet shumë në atë se çfarë lexuesit kanë nevojë dhe çfarë botuesish duan; botuesit kanë dhe duhet të kenë në vazhdimësi tendencë për t'iu përgjigjur kërkesave të publikut/lexuesve.

LIBRAT DHE TEKNOLOGJIA: ROLI I TYRE

Ajo që duhet të mbahet mend për librin është se pavarësisht nga zvogëlimi i ndikimit të tij dhe ofrimi i disa parakushteve që tentojnë ta shkatërrojnë atë, prapë se prapë nuk është arritur që ta zhvleftësojnë fuqinë e librit, i cili vazhdon ta ruajë shkëlqimin e tij përkrah fotokopjes, telefonit, faksit dhe printerit.

Nuk mohohet fakti se ka raste ku punëtorët hulumtues kërkojnë informacione specifike dhe shumë të specializuara për të shkuar drejt një arritje sa me të madhe profesionale. Teknologjia e re e ka epërsinë në këtë kërkim për materialet referale dhe kërkimet në baza të dhënash. Sidoqoftë nxitja intelektuale dhe ideore që provohet në leximin e një romani apo drame ose në leximin e teksteve studimore, përmes librit pra tekstit tradicional, është arritja me e mirë që ne e njohim sot.

Është absurd të thuhet se miliona libra që tashmë ekzistojnë të botuara

dhe qindra apo mijëra libra që publikohen për çdo vit, mund të mënjanohen në favor të një ekrani kompjuteri, që në kombinim me një bazë të dhënash në internet shfaqin rezultatet e kërkimit.

Bibliotekat do të mbeten qendra të bashkëveprimit midis repozitorëve fizikë të cilët e strukturojnë librin dhe krijimit të mundësisë për qarkullim informacioni, gjë që krijon kushte për të shpërndarë atë. Dhe, në këtë mënyrë bibliotekat do të vazhdojnë procesin e ruajtjes së kulturës njerëzore dhe jetesën e regjistruar gjatë shumë shekujve dhe në shumë gjuhë.

PROFETËT E ERRËSIRËS

Unë nuk e ndaj mendimin me parashikimin ogurzi të profetëve të errësirës të cilët profetizojnë përfshirjen madhe në shkencat e informacionit.

Këta individë janë dëgjuar të thonë se deri në vitin 2000 botimet e shtypura do të jepen tërësisht në mënyrë elektronike, prognoza ishte se një shkencëtar në vitin 2000 nuk do të ketë nevojë të shkruajë ose të vizitojë një bibliotekë gjatë zhvillimit të punës së tij. Është parashikuar që ai do të ketë të gjitha informacionet që i nevojiten në një bazë të dhënash bibliografike përmes të cilave do ta finalizojë punën e tij. Tashmë është provuar se këta profetë të errësirës janë gabuar.

Megjithëkëtë nuk duhet, dhe nuk është e nevojshme që të shkohet deri në ekstrem me mbrojtjen e librit të shtypur siç është bërë në disa vende amerikane, ku dy ditë në javë janë shpallur si ditë jotelevizive për të luftuar efektet negative të këtij medium.

E ARDHMJA E LIBRIT

Asnjë përpjekje nuk duhet të jetë e tepërt për të promovuar kauzën e librit. Një ish-bibliotekar i Bibliotekës së Kongresit, Dan Boorstin (një historian) dhe një ish-drejtor i Bibliotekës Britanike, Harry Hookway, japin shembuj të shkëlqyer në këtë drejtim. Të dy konsiderojnë se mjetet e reja të informacionit rikthehen si modifikime dhe jo si kundërshtime të metodave të mëhershme.

Për analogji, zbulimi i fotografisë nuk e solli me vete fundin e pikturës, paraqitja e gramafonave nuk rezultoi me përfundimin e shfaqjeve të koncerteve të gjalla, hyrja e radios në shoqëri nuk rezultoi me vdekjen e gazetave, teatri nuk u la anash edhe pas paraqitjes së kinemasë. E ngjashme është edhe çështja e shfaqjes së bazës së të dhënave të kompjuterizuara. Publiku e përdor atë për informata të caktuara, dhe baza e të dhënave duhet t'i shërbejë qëllimit të tyre, por e ardhmja e librit të shtypur mbetet e sigurt.

Underwood (Deborah Underwood), në kumtesën e saj të rëndësishme, të mbajtur me rastin e Konferencës së shtatë të Bibliofilisë në Afrikën e Jugut, në Cape Town, edhe pse duke pranuar rolin e rëndësishëm të mediave elektronike, doli fuqishëm në mbrojtje të librit të shtypur duke thënë: *"Më lejoni të them se unë nuk mendoj se libri do të jetë ndonjëherë i zëvendësuar. Ai është i suksesshëm si një mjet dhe mund të jetë i bukur si objekt. Ky është gjithashtu kulmi i eksperiencës dhe eksperimentimit shumëshekullor, një proces që vazhdon. Për krahasim, hartimi dhe paraqitja e dokumenteve elektronike aktualisht paraqet një fazë të hershme në procesin e zhvillimit".*

BIBLIOTEKAT, BIBLIOTEKARËT DHE NDRYSHIMI

Nuk ka kuptim që të parashikohet në mbarimin e bibliotekave kështu siç ne i njohim sot. Biblioteka, pa marrë parasysh çfarë është ajo, bibliotekë universitare apo publike, nuk është vetëm një ndërtesë për konservimin e dijeve, por një mjet për organizimin dhe shpërndarjen e informacionit. Është roli i bibliotekarit me tepër se i vetë bibliotekës ai i cili ka ndryshuar në epokën e re të informacionit.

Megjithëse biblioteka ka ndryshuar fizikisht për të akomoduar teknologjinë e re, ajo sërish mbetet qendër fokusimi për miliona njerëz që shfrytëzojnë bibliotekat çdo ditë: për edukim, informacion dhe rekreacion.

Ekspertët pajtohen se zhvillimet e viteve të fundit mund të përbëjnë kërcënim për profesionin e bibliotekarit, por megjithëse ekziston kjo sfidë, kjo do të tejkalohet me kujdesin e profesionistit për komunitetin e përdoruesve ashtu si nuk është njohur asnjëherë me parë. Maurice Line, ka dhënë shembullin e balancimit më të mirë të parashikimit të së ardhmes.

Line, i njohur dhe i respektuar në masë të madhe në komunitetin e bibliotekarëve në botë, është i vetëdijshëm në rreziqet që mund të dalin nga përpjekja për parashikimin e bibliotekarëve në të ardhmen, veçanërisht kur dihet se shumë parashikime kanë dështuar. Kjo sigurisht ka qenë në rastin e teknologjisë se telekomunikacionit, në automatizimin e indekseve dhe në makinën e përkthimit.

Një komplikim është se qeniet njerëzore reagojnë në mënyra të ndryshme dhe çuditërisht të paparashikueshme ndaj zhvillimit të teknologjisë, dhe ndonjëherë arrihet në situatë të pazgjidhshme kur njerëzit nuk e pëlqejnë një zhvillim të caktuar dhe refuzojnë ta përdorin atë.

Line beson se edhe në 2025 do të ketë jo me pak gazeta të shtypura, por shumë prej tyre do jenë në dispozicion në dy forma, të shtypura dhe elektronike. Shumë materiale që janë të shtypura në të tashmen do të jenë të

ruajtura në baza të dhënash në një bazë kooperative. Gazetat e "popullarizuara" do të vazhdojnë të ekzistojnë në formën e tanishme. Line, parasheh se librat nuk do të ndikohen në masë të madhe krahasuar me gazetat ose revistat.

Disa libra (me shitje të kufizuar) do të publikohen në përshtatshmëri me kërkesat e lexuesve, mirëpo disa kategori është e sigurt se do të përfitojnë nga revolucioni elektronik; ndër to janë tekstet referale, librat mbi artet e bukura dhe muzikën, të cilat mund të përfitojnë nga mediat e përziera, librat për studentë, të cilat lehtë mund të ruhen në disqe dhe lehtësisht të bëhen të përdorshme si "libra elektronik".

Parashikimi i Line është që librat dhe revistat e shtypura do të vazhdojnë të ekzistojnë bashkë me shumëllojshmërinë e mediave elektronike dhe qasjes online në shumë materiale. Mediat e informacionit qofshin të shkruara apo elektronike, ende do të duhet të ruhen dhe të arrihen nëpërmjet bibliotekave, pasi që nuk ka pajisje alternative të cilat të jenë kaq mirë të organizuara për të përmbushur këto funksione.

Mediat elektronike do të vazhdojnë të jenë në dispozicion të komunitetit akademik, kompleksiteti industrial përmes lidhjes në rrjet me qasje online, tashmë mundësohet nga shtëpia, laboratorët e punës, zyrat ose brenda vetë bibliotekës.

Line kompleton këtë skenar paraqitjeje, duke u kujtuar lexuesve të harduerëve shumë të shtrenjtë, faktin se shumë katalogë të bibliotekave do të kenë automatizuar përmbajtjen e tyre deri më 2025, duke e filluar këtë me realizimin e materialit me përmbajtje nacionale (sikurse SABINET), për të vazhduar më tej me gjithë përmbajtjen e bibliotekës që mundëson një qasje universale në këto të dhëna.

Bibliotekat, krahas gjithë zhvillimeve teknologjike, do të bëjnë punën e tyre në krijimin e kushteve të favorshme në ndihmën dhe ofrimin në qasje të informacionit. Bibliotekat gjithnjë do t'i përshtaten ritmit të zhvillimeve teknologjike në vitet në vijim. Bibliotekarët po ashtu do të zhvillohen në përputhshmëri me këtë zhvillim, dhe kështu nga një bibliotekar konvencional që vazhdon të kryejë funksionin e tij, sot duhet të kthehet në një bibliotekar me eksperiencë, i fuqishëm në njohjen e funksionimit të mënyrës automatike të të dhënave, duke u përcjellë me një njohuri më profesionale në fushën e marketingut dhe me njohuri të mira menaxhuese.

Një parashikim tejet radikal për çerekshekullin e ardhshëm është dhënë në një ese të shkruar nga dy njohës të mirë të bibliotekave, Lauren H. Seller, si dhe profesori i bibliotekarisë dhe shkencës së informacionit - Tomas H. Surprenant, të cilët thonë se fundi i bibliotekës klasike pritet të ndodh. Shtypjet e shkrimit në letër vazhdojnë të kenë rënie, dhe ka fundi i shekullit 21 të gjitha informatat do të ruhen në formë shifrash.

Mirëpo ata besojnë se bibliotekat klasike nuk shkojnë drejt vjetrimit, për aq kohë sa informacioni është i gatshëm të shfrytëzohet, të ofrohet te lexuesi, dhe për aq sa dijetarët kanë praktikisht nevojë të pakufizuar për ta marrë informacionin e caktuar.

Por, megjithëkëtë, ata pohojnë së është padyshim lehtë të shihet se bota e bibliotekave po lëviz në drejtim të asaj qe ata e quajnë Qendër Virtuale e Informacionit.

Ky besim i tyre mbështetet në faktin se dijetarët dhe studiuesit tashmë e kanë mundësinë të ulen para kompjuterëve të tyre dhe nga aty të kenë qasje në të gjitha informata që kanë në dispozicion të gjitha bibliotekat e botës, për aq sa ekzistojnë format e bashkëpunimit midis informacionit të kërkuar dhe mundësisë që ofron baza e të dhënave.

Qendra e tyre Virtuale e Informacionit, përfshin botën e librit të shtypur që është arritur gjatë gjithë këtyre viteve, duke e ruajtur atë në një "dhomë" të vogël, pa e pasur nevojën e prekjes ose njohjes fizike.

Dikush nuk mund ta pranojë pa rezerva serioze mendimin e tyre, që shtypja e shkrimit në letër mund të shihet tani si një mundësi e zhvilluar dikur, ose për përdoruesit e teknologjisë

së re kjo të shihet vetëm si histori nga e kaluara.

Nga këtu mund të konkludojmë se asgjë tjetër nuk mund të jetë më larg të vërtetës sesa ky pohim, dhe për këtë vetëm të marrim në konsideratë vizionin që pamë më lartë që Line ka dhënë për këtë situatë!

Penniman, një tjetër emër i njohur nga fusha e bibliotekarisë në botë, në njërin nga shkrimet e tij i jep rëndësi të veçantë asaj se nëse bibliotekarët janë për të shërbyer dhe luajnë një rol kreativ, ata në vazhdimësi duhet të mbijetojnë dhe të vazhdojnë të kenë jo vetëm rolin e kujdestarit por edhe të mësuesit, duke e pamundësuar vjetrimin e pasurisë së tyre, dhe duke e vazhduar rolin që ata kanë ndaj shërbimit të njerëzimit pavarësisht shërbimeve alternative që mund të zhvillohen me teknologjinë e re. Sepse bibliotekarët nga ana e tyre kanë strategji për zhvillimin e strukturave shoqërore, sikurse e kanë edhe strategjinë për zhvillimin e institucionit në të cilin banojnë.

Penniman beson se bibliotekat mund të rrezikohen vetëm në rast dështimi në udhëheqjen e tyre, pikërisht atëherë kur sistemet e ruajtjes kanë prioritet mbi sistemet e shpërndarjes. Ai shton se bibliotekarët kanë nevojë për të ripërcaktuar kufijtë e tyre, duke e dërguar hulumtimin e tyre deri te njohja e pikëpamjeve të përdoruesit si dhe deri te konstruktimi i sistemeve kërkuese.

Nga kjo shihet e nevojshme se të gjithë ata që jetojnë dhe punojnë jashtë SHBA-ve duhet të kenë një njohje me të përafërt mbi aktivitetet e Këshillit mbi Pasurimin e Bibliotekave dhe Fondacionit të Andrw Mellon-it, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm për nxitjen dhe hulumtimin mbi pikat kyçe që mund të ndihmojnë bibliotekat jo vetëm për të



mbijetuar, por edhe për të lulëzuar në mjedisin tonë, që është vazhdimisht duke ndryshuar.

Është e qartë që biblioteka para se gjithash duhet të shihet si sistem i shpërndarjes së informacionit e jo si depo. Drejtuesit e bibliotekave tona duhet të kenë aftësitë e nevojshme për zbatimin e këtij sistemi.

Shumë njohës të bibliotekave japin mendimet e tyre mbi këtë sistem të shpërndarjes se dijes me emrin **bibliotekë**, disa prej tyre mund t'i shohim me sa vijon:

Molholt mendon se ne kemi nevojë për ndërtimin e një plani, i cili e përcakton bibliotekarin jo si roje të librit por udhëzues drejt rrugës së universit të dijes.

Ne kemi nevojë për të krijuar mjedise që t'u shërbejnë nevojave të përdoruesve tonë në mënyrë të përputhshme me natyrën e tyre kërkuese e hulumtuese. Është esenciale aftësia e bibliotekarit për të paraparë kërkesat e përdoruesve, pastaj përpjekja e vazhdueshme për të marrë rolin e informuesit sa më të plotë, do të jetë një masë përcaktuese për fatin e bibliotekarit në të ardhmen.

Dowlin, përfaqësues i bibliotekave publike gjithashtu thekson nevojën për ndryshim në këtë profesion. Dowlin mendon se shkollat e bibliotekarisë kanë prodhuar të diplomuar të cilët janë mjeshtër të aftë në klasifikimet bibliotekare por mungesë e këtyre shkollave është se ata nuk prodhojnë arkitektë të vizioneve.

Raitt, një udhëheqës evropian i Teknologjisë Informative, ka këtë pikëpamje për bibliotekarët: ata duhet të jenë me imagjinativë, me të gatshëm për të eksperimentuar, më mendje hapur, sepse vetëm atëherë ata mund të krijojnë një të ardhme për bibliotekën dhe për vetveten.

Mënyra e vetme për t'i bërë përdoruesit e bibliotekave që të përfshihen në këto teknologji të reja është përmes arsimimit dhe informimit, dhe këtë duhet ta bëjnë bibliotekarët! Ata duhet gjithmonë të kenë njohuri mbi teknologjitë e reja dhe se si ato duhet të përdoren, dhe në këtë mënyrë arrihet drejt përmirësimit të shërbimit të informacionit.

Debati i madh vazhdon! Vizioni i kujtdo të jetë më i saktë? Por, ajo çfarë është e sigurt, është se do të ndodhin ndryshime të rëndësishme përgjatë zhvillimit të botës dhe ku ne do të jemi dëshmitarë që burimet e shumta të informacionit, inspirimit dhe këna-

qësisë që mbart me vete ky zhvillim, do ta kenë vlerën e vet.

Dhe. këto ndryshime do të kenë një ndikim të madh në biblioteka dhe në bibliotekarë.

Ajo që është më shqetësuese në lidhje me këto "vizione" është se profesionistët që pamë më lartë e shprehin një pasiguri për sa i takon bibliotekarit dhe udhëheqjes në biblioteka, dhe ku tregohet se bibliotekarët është e nevojshme të jenë të kujdesshëm me këto ndryshime dhe që duhet të punohet shumë që gjithë këto ndryshime të kthehen në favor të tyre.

Alarmuese është prognoza e shprehur më lart që bibliotekarët janë në rrezik në mungesë të një shkolle të vërtetë vizionare. Nëse kjo situatë është e vërtetë, atëherë cila mund të jetë sfida që mund të paraqitet për vendet e botës së tretë?

E ARDHMJA E INDUSTRISË BOTUESE

Zhvillimi i shpejtë që po ndodh në shekullin tonë, ka prodhuar edhe idenë se mediat e shkruara, në një kohë të afërt janë të destinuara që të zhduken, për shkak të hovit që kanë marrë mediat elektronike.

Kjo pikëpamje vjen si rezultat i një numri të caktuar personash ose shoqërisë që në fakt kanë problemet e tyre personale në raport me librat, gazetat dhe revistat, ose në tërësi me industrinë e botimeve dhe kështu rregullisht e proklamojnë vdekjen e tyre.

Lajm i mirë për mediat e shkruara është se po vazhdon te ketë mjaft jetë akoma brenda tyre. Një lajm i keq, të paktën për njerëzit që i gëzohen të lexuarit në letër të shtypur është se vetë botuesit e letrës së shtypur shpesh kanë qenë armiqtë e tyre më të këqij, duke bërë para syve të lexuesit përshpejtimin e ndryshimeve teknologjike.

Interneti nuk është për zëvendësimin e shkrimit, por është për të realizuar të gjitha gjërat e tjera që shkrimi nuk ka mundur t'i bëjë, dhe për përmirësimin e gjërave që ndonjëherë shtypi nuk ka arritur t'i realizojë, duke ofruar shërbim me të shpejtë dhe më të lirë te përdoruesit.

Çështja e shtypit shpesh është neglizhuar nga protagonistët e revolucionit teknik, duke anashkaluar të shkruarit sensual dhe me përcjellje të mendimit. Përmbajtja e lartë e mendimit gjendet rrallë në ndonjë media tjetër përveç letrës. Edhe nëse është e mundshme që brezat ardhshme të mësojnë të lexojnë në ekranin e kompjuterit, kjo do të marrë të paktën disa breza të shoqërisë perëndimore për të tunduar dashurinë mijëvjeçare për letër dhe bojë.

Në çdo rast, botimi nuk është një përpjekje e cila duhet të përputhet gjithmonë me ekonominë strikte darviniste - zvogëlimi i lexuesve ende nuk e ka penguar dike në botimin e një libri ose gazete.

Është e rëndësishme të përmendet këtu, ajo që po ndodh në një nga bizneset më të suksesshme të shitjes online në internet, shitësin Amazon, që vetëm tri vite pas fillimit të funksionimit të saj ka bërë që të arrijë shitjen deri në një milion dollar në ditë, vetëm përmes internetit, gjë që e bën këtë librari virtuale ndër tre libërshitësit me të mëdhenj në botë, pa pasur nevojë që të hap treg, pa pasur nevojë që të përballet me shpenzimet e shumta që do t'i kishte një librari fizike, nisur nga inventari, personeli dhe problem të tjera teknike.

Kjo faqe interneti iu lejon konsumatorëve kërkimin dhe shfletimin e librave të parapaguara. Dhe, duke shkuar edhe përtej kësaj, kjo faqe ofron rekomandime të lexuesve, duke mundësuar kështu një paraqitje të pikëpamjeve të lexuesve, gjë që tërheq vëmendje dhe kujdes të shtuar nga lexuesit/blerësit. Por, megjithëkëtë, kjo nuk përbën rrezik për median e shkruara, sepse pjesa më e madhe, për të mos thënë të gjitha librat që shiten te kjo librari elektronike, fillimisht ekzistojnë si tekste fizike, pastaj vazhdojnë procedurat e tjera të tërheqjes së saj ndaj lexuesit.

Rrezik real për median e shkruar përbën zëvendësimi gradual i disa prej funksioneve të tyre. Paaftësia e tyre për të sjellë forma të reja nuk e justifikon mosshitjen si rezultat i teknologjisë se re.

Gazetat kanë më shumë frikë se librat ose revistat, por për çudi më së paku frikë kanë televizionet. Prej 100 000 përdoruesve të internetit të anketuar, 25% thanë se ata shikojnë më pak televizor për shkak të internetit, ndërsa vetëm 14% thanë se ata lexojnë më pak, pothuajse 100% pohuan se interneti nuk e pakëson konsumimin e mediave të tjera.

Në të vërtetë, industrinë botuese e ka dekurajuar më së shumti mosblerja e mediave të shtypura, mirëpo nga përvoja ime si bibliotekar dhe si njohës i lexuesve dhe anketues i tyre, krejt në fund mund të shtoj se interneti është vetëm një justifikim për rënien e shitjes së botimeve, sepse problemi i kësaj duket se qëndron të ata botues që kanë humbur rrugën e tyre.

Nuk ka dyshim se në shekullin që shtrihet pra nesh, njerëzit do të vazhdojnë të lexojnë libra, gazeta dhe revista, por vetëm për aq kohë sa ato janë shkrime dhe botime me vlerë.

(Reuben Musiker, është bibliotekar dhe autor i dhjetëra librave nga fusha e bibliotekarisë. Ky artikull është marrë nga South African Journal of Library & Information Science, Vol. 66, Issue 4, p176*)*

Nga anglishtja: Jehona SHALA

BIBLIOTEKA E KONGRESIT

(NJË HISTORI E SHKURTËR)

Biblioteka e Kongresit u krijua nga një akt i Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vitin 1800, kur presidenti i atëhershëm, John Adams, nënshkroi një ligj që parashikon transferimin e selisë së qeverisë nga Filadelfia në qytetin e ri të Uashingtonit, i cili u bë kryeqytet i SHBA-ve. Legjislacioni amerikan parashikoi një bibliotekë referimi vetëm për Kongresin, e cila do të përmbante libra që janë të nevojshme për përdorim nga Kongresi, si dhe për ndërtimin e një ndërtese të përshtatshme për t'i vendosur librat që do të gjendeshin në bibliotekë.

Themeluar me 5000 (pesë mijë dollarë), të ndara nga legjislativi amerikan, biblioteka u vendos në Kapitol, në ndërtesën e re në gusht të vitit 1814, pasi që trupat pushtuese britanike i vunë zjarrin building-ut (ndërtesës) Kapitol, djegie, e cila i bëri gërmadhë tërë bibliotekat e atëhershme të vogla.

Brenda një muaji, presidenti në pension, Thomas Jefferson, ofroi bibliotekën e tij personale si një zëvendësim për librat e djegura. Jefferson kishte kaluar 50 vjet në mbledhjen e librave. Ai i dha bibliotekës së re çdo gjë, çdo libër, që kishte të bënte me Amerikën, dhe në të vërtetë çdo gjë që kishte ishte e rrallë dhe e vlefshme për çdo shkencë. Biblioteka personale e Jeffersonit është konsideruar të jetë një nga më të mirat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në një konferencë lidhur me mbledhjen e librave për Bibliotekën e Kongresit, Jefferson kishte parashikuar polemika në lidhje me natyrën e mbledhjes së fondeve për këtë bibliotekë, e cila përfshinte libra në gjuhë të huaja dhe vëllimet e filozofisë, shkencës, letërsisë, dhe libra me tema të tjera, të cilat normalisht se nuk mund të shihen si pjesë e një biblioteke legjislative. Ai, në një rast, shkroi, *"unë nuk e di se Biblioteka përmban ndonjë degë apo shkencë, që kongresistët do të dëshironin ta përjashtonin nga fondi i saj. Nuk ka! Në fakt, nuk ka ndonjë libër në të cilën një anëtar i Kongresit nuk do të mund të ketë rast për t'iu referuar."*

Në janar 1815, Kongresi pranoi ofertën e Jeffersonit, dhe i dha 23,950 (njëzet e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) dollarë për t'i blerë 6487 (gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) libra nga fondi personal i presidentit në pension. Me këtë janë hedhur themelet e para për një bibliotekë të madhe kombëtare. Koncepti i universalitetit jeffersonian, besimi se të gjitha subjektet janë të rëndësishme për bibliotekën e legjislativit amerikan, është filozofia racionale e politikave të plota për mbledhjen e fondeve, që ndodh sot në Bibliotekën e Kongresit.

Einsuorth Rand Spofford, bibliotekar i Kongresit 1864-1897, kishte aplikuar filozofinë e Jeffersonit në një shkallë të madhe dhe e shndërroi bibliotekën në një institucion kombëtar. Spofford ishte përgjegjës për ligjin e autorit të viti 1870, i cili kërkonte që të gjithë autorët t'ia dërgonin Bibliotekës nga dy kopje të veprës së tyre. Kjo rezultoi me sukses, sepse në bibliotekë pati "vërshime" me libra, pamflete, harta, muzikë, printime dhe fotografi. I përballur me një mungesë të hapësirës dhe rafteve në Kapitol, Spofford e bindi Kongresin për nevojën e një ndërtese të re. Andaj, Kongresi në vitin 1873 autorizoi një konkurs për hartimin e planit për godinën e re të Bibliotekës.

Në vitin 1886, pas shumë propozimeve dhe shumë polemikave, Kongresi miratoi planin për ndërtimin e një ndërtese të re Biblioteka në stilin e Rilindjes italiane, në përputhje me

një dizajn, të cilin e përgatitën në Uashington, arkitektët John L. Smithmeyer dhe Paul J. Pelz.

Ky vendim i Kongresit për ndërtesë të re ishte i suksesshëm falë punës së madhe të dy senatorëve kryesorë: Daniel W. Voorhees (Indiana), i cili shërbeu si kryetar i Komitetit të Përbashkët 1879-1881, dhe Justin S. Morrill (Vermont), kryetar i Komitetit të Senatit për Ndërtesat.

Më 1888, gjenerali Thomas Linkoln Casey, shefi i Korpusit të Inxhinierëve të Ushtrisë, ishte vendosur në krye të ndërtimit. Asistent i tij kryesor ishte Bernard R. Green, i cili, deri në vdekjen e tij në 1914, ishte i përfshirë ngushtë me ndërtimin e godinës së re. Në fillim të vitit 1892, një arkitekt të ri, Eduard Pearce Casey, i biri i gjeneral Casey, filloi të mbikëqyrë punën e brendshme, duke përfshirë dekorimet skulpturore dhe pikturat, e bëra nga më shumë se 50 artistë amerikanë.

Ndërtesa e re e Bibliotekës së Kongresit hapi dyert e saj për publikun më 1 nëntor 1897, dhe u përshëndet e u vlerësua si një monument i lavdishëm kombëtar, si dhe si nga një nga ndërtimet "më të mëdha dhe më të sigurta" në historinë e ndërtimit të bibliotekave në botë.

KOLEKSIONE

Biblioteka e sotme e Kongresit është një burim i pashembullt botë. Ajo ka mbledhur në fondin e saj më shumë se 144 (njëqind e katër dhjetë e katër) milionë artikuj, si dhe përfshin më shumë se 33 milionë libra të kataloguara dhe materiale të tjera të shtypura në 460 gjuhë. Po ashtu, ka më shumë se 63 milionë dorëshkrime, gjë që e bën atë si qendra më e madhe e grumbullimit të librit të rrallë në Amerikën e Veriut, si dhe qendra më e madhe në botë e grumbullimit të materialeve ligjore, filmave, hartave, muzikës, incizimeve etj.

KOMITETI I PËRBASHKËT MBI BIBLIOTEKËN

Komiteti i Përbashkët mbi Bibliotekën (është komitet i vjetër dhe i vazhdueshëm i Komiteti të Përbashkët të Kongresit të SHBA-ve) u krijua më 24 prill 1800, kur presidenti John Adams nënshkruan projekt-ligjin për themelimin e qeverisë federale në Uashington dhe krijimin e Bibliotekës së Kongresit. Akti i ndarjes së shumës prej 5.000 dollarëve për *"blerjen e librave të tillë, që janë të nevojshme për përdorimin e Kongresit",* pasi ajo u zhvendos në qytetin e ri të Uashingtonit. Biblioteka e Kongresit për herë pati në vitin 1811 e dha fondin e saj financiar. Ky fond zyrtarisht u miratua në Komitetin e Përbashkët mbi Bibliotekat, një komitet i rëndësishëm atëkohë. Komiteti i Përbashkët mbi Bibliotekat ka qenë i përbërë nga kryetari (ose personi i caktuar) dhe katër anëtarë, secili prej tyre ishte nga Komiteti i Senatit për Rregullat dhe Administratën dhe Komiteti për Shtëpinë e Administratës. Udhëheqja ndryshohej dhe zëvendësohej nga herë nga njëri anëtar i Senatit, herë nga një anëtar i Shtëpisë.

BIBLIOTEKARI I KONGRESIT

James Hadley Billington u propozua në vitin 1987 nga presidenti Ronald Regan, si Bibliotekar i 13 (trembëdhjetë) i Bibliotekës së Kongresit. Ai bëri betimin për punën e tij në Sallën e Madhe të Bibliotekës, më 14 shtator 1987.

Marrë nga:
http://www.libraryhistorybuff.com/ala-history.htm;
http://www.loc.gov/about/history.html

Nga anglishtja: **A. Olluri**

SHËRBIMET NË EBSCO

Burimet elektronike të EBSCO-së ofrojnë një numër të madh të bazave të dhënave bibliografike dhe me tekst të plotë, të cilat plotësojnë nevojat për informacion të të gjitha llojeve të bibliotekave kudo në botë.

EBSCO ka botime dhe shërbime të specializuara për biblioteka universitare, mjekësore, qeveritare, shkollore dhe publike, si dhe për institucione dhe gazeta. Duke përbërë një bazë të të dhënave me më se 60.000 botues kudo në botë, ajo i shërben komunitetit bibliotekar që nga viti 1944.

Në burimet elektronike të kësaj kompanie tash e sa vite ka qasje edhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe të gjithë anëtarët e Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës.

Përdoruesit e burimeve elektronike të EBSCO-s mund të bëjnë kërkimin në këtë bazë të të dhënave që mbulojnë pothuajse, të gjitha fushat e studimit akademik, duke përfshirë: shkencat kompjuterike, inxhinierive, fizike, kimike, pastaj fushat e gjuhësisë, artit dhe letërsisë, shkencat mjekësore, studimet etnike, studime të ambientit dhe jetesës dhe shumë fusha të tjera.

Gjithashtu, edhe nga fusha e biznesit, EBSCO ofron një numër të madh të artikujve me tekst të plotë të më se 2.300 periodikëve, duke përfshirë këtu afro 1100 botime nga fusha e biznesit, të redaktuara nga shkencëtarë përkatës. Business Source Premier është konkurrenti më i madh botëror në ofrimin e shërbimeve informative të të gjitha llojeve të biznesit, përfshirë marketingun, menaxhmentin MIS, POM, llogaritjet, financat dhe ekonominë. Kjo bazë e të dhënave ofron tekste të plota nga revistat kryesore botërore të menaxhmentit dhe marketingut.

Përparësi e kërkimit është se mund të bëhen edhe kërkime imazhesh në pjesën më të madhe të revistave shumica prej tyre me karakter hulumtues.

Në bazën e të dhënave që ofron tekste nga fusha e biznesit karakterizohet edhe ajo biznesit rajonal me afro 80 revista të biznesit, gazetave si dhe agjencive të ndryshme të lajmeve nga të gjitha hapësirat rurale dhe metropolitane brenda Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Bazë e rëndësishme që ofron tekste në fushën e arsimit dhe edukimit në literaturë dhe burime arsimore dhe edukative është edhe baza e të dhënave ERIC.

Kjo bazë e të dhënave ofron qasje në informacionet nga revistat që janë të përfshira në "Index of Journals in Education" dhe "Resources in Education Index". ERIC ofron tekst të plotë 323,000 dokumenteve për edukim që nga viti 1966.

Bazë e hartuar posaçërisht për bibliotekat publike - Master FILE Premier, ofron tekst të plotë të rreth 1.700 botimeve referuese të karakterit të përgjithshëm. Duke përfshirë të gjitha fushat me interes të përgjithshëm si: biznesi, arsimimi, shëndetësia, shkencat e përgjithshme, kjo bazë përfshin gjithashtu edhe indekse dhe abstrakte, duke mbuluar 2.400 tituj.

Edhe baza e të dhënave GreenFILE është bazë e re që ofron informacione të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e ndikimit të njeriut me mjedisin. Koleksionet shkollore, qeveritare dhe të përgjithshme përfshijnë tituj me përmbajtje mbi ndikimet mjedisore të individëve, korporatat dhe qeveritë lokale dhe kombëtare, dhe çfarë mund të bëhet në çdo nivel për të

Statistikat vjetore të kërkimit në EBSCO, për vitin 2010, nga përdoruesit në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

Institucioni	Viti	Numri	Koha mesatare e kërkimit	Kërkues	Gjithsej tekste të plota	Tekste të plota në PDF	Tekste të plota në HTML	Imazhe / Video	Abstrakt	Lidhjet	Porositë
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës	2010	2729	45	40113	5312	4044	1256	12	6427	297	0
Gjithsej		**2729**		**40113**	**5312**	**4044**	**1256**	**12**	**6427**	**297**	**0**

minimizuar këto efekte. Bazë multidisiplinare nga natyra, GreenFILE përfshin lidhjet mes mjedisit dhe një shumëllojshmëri të disiplinave të tilla si bujqësia, arsimi, ligji, shëndeti dhe teknologjia. Kjo bazë ofron indekse dhe abstrakte të më shumë se 538.000 njësive, si dhe qasje në tekste të plota në më shumë se 5.800 njësi.

Për fushën e Bibliotekës, Shkencave të informacionit dhe teknologjisë kjo bazë ofron abstrakte të më shumë se 500 gazetave, revistave, librave, raporte hulumtuese etj.

Kjo bazë mbulon tema nga klasifikimi, katalogimi, shërbimi i informacioneve, menaxhimin e informacioneve e shumë të tjera.

Informacione me rëndësi përdoruesit mund të marrin edhe në bazën Newspaper Source, e cila ofron tekste të plota të 30 gazetave nacionale të SHBA-ve si dhe gazetave ndërkombëtare.

Për fushën e mjekësisë, EBSCO ofron publikime në disa baza të të dhënave siç janë MEDLINE, që është bazë kryesore e të dhënave me informacionet kompetente në të gjitha fushat mjekësore, si: infermieri, stomatologji, mjekësi, shkenca paraklinike, veterinari, etj. E krijuar nga Biblioteka Kombëtare e Mjekësisë në SHBA, ajo ofron katalogun e kësaj biblioteke, duke përfshirë citime hulumtuese të më se 4.800 revistave biomjekësore, imazhe të ndryshme etj.

Bazë tjetër e shëndetësisë që ofron tekste të plota të afro 550 revistave, që janë të fokusuara në disiplina mjekësore, është edhe Health Source: Nursing /Academic Edition. Në këtë bazë përfshihen tema të ndryshme me tekst të plotë nga fusha e infermierisë, si: kujdesi kreativ, çështje në kujdesin e përgjithshëm pediatrik, çështje në kujdesin e shëndetit mental, kujdesi i avancuar, kujdesi psikiatrik i adoleshentëve dhe fëmijëve, kujdesi klinik,

kujdesi i shëndetit shoqëror, menaxhimi i kujdesit, etika e kujdesit, forumi i kujdesit, kërkesat e kujdesit, dhe shumë çështje të tjera lidhur me kujdesin si disiplinë shëndetësore.

Edhe Health Source - Consumer Edition, bazë e të dhënave, është ndër koleksionet më të pasura për ofrimin e informacioneve të shëndetësisë në rrjetin e përgjithshëm botëror të bibliotekave. Kjo siguron informacione në shumë tema shkencore, shkencat e teknologjisë ushqimore, kujdesin ndaj fëmijëve, mjekësinë e sportit dhe shëndetin e përgjithshëm. Ofron tekst të plotë në 150 revista si dhe ripërtërihet në baza ditore.

Clinical Pharmacology ofron qasje në monografi të përmbledhura të barërave mjekësore - për të gjitha përshkrimet e barërave në SHBA. Kjo bazë e të dhënave, gjithashtu ofron informacione për prodhime dhe studime në këtë fushë.

Përdoruesit mund të kenë qasje në të gjitha këto baza të të dhënave dhe të bëjnë hulumtime për fusha të caktuara. Kompania EBSCO, duke e parë zhvillimin e teknologjisë dhe dinamikën e përditshme për lehtësimin e kërkimit në këto baza, ka mundësuar qasje nëpërmjet EBSCOmobile (telefonisë mobile).

Gjithashtu, për lehtësim kërkimi dhe ruajtje të artikujve të ndryshëm, hulumtuesit mund të krijojnë adresë përmes My EBSCOhost dhe të grumbullojnë artikujt e kërkuar që u duhen për studim të mëtutjeshëm. Këta artikuj mund të ruhen në folderët e my EBSCOhost, të cilin mund ta aktivizojnë vetë përdoruesit e bazës së EBSCO-s.

Përgatiti: Bukurije Haliti



Hapja e ekspozitës së librave së Nëna Terezes

LIBRAT PËR NËNË TEREZEN

Prishtinë, 21 dhjetor

Në shenjë të 100 vjetorit të lindjes, është hapur, në BKUK, ekspozita e librave për Nënë Terezen, të cilët janë shkruar nga autorë të huaj dhe shqiptarë. Kjo ekspozitë është organizuar nën përkujdesjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës dhe në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Nga 297 tituj të librave për Nënë Terezen, që i përkasin fondit të ruajtur nga Don Lush Gjergjit - njërit nga biografët më të njohur në botë të kësaj humanisteje, janë paraqitur rreth 100 sosh, prej tyre 15 të shkruara nga ky autor, tituj këta që janë përkthyer në më shumë se 30 gjuhë të botës.

Me rastin e kësaj ekspozite, Don Lush Gjergji ka folur për rëndësinë e këtij aktiviteti në nderim të 100-vjetorit të lindjes së Nënë Terezes, duke theksuar se këto libra të ekspozuar janë thesare dhe mrekulli në kujtim të figurës së Nënë Terezes.

Në emër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, z. Shefki Ukaj, ka theksur se kjo ekspozitë përcillet me një katalog, në të cilin janë përfshirë ballinat e librave të shumtë, që autorë të ndryshëm i kanë kushtuar Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Terezes. Ky katalog, theksoi ai, së bashku me librat e tjerë, që janë botuar në gjuhën shqipe, angleze e gjermane për Nënën Tereze, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosocvës shumë shpejt do të dërgohen në ambasadat e Republikës së Kosovës, në vendet mike.

Me rastin e kësaj ekspozite, drejtori i BKUK-së, Sali Bashota, ka mbajtur fjalimin: "Nëna e dashurisë në gjuhët e botës", me ç'rast ka theksuar se si fryma e pavdekësisë e valëvitur në qytetërimin botëror me ndjenjën e fuqishme njerëzore të bamirësisë së një Nëne Shqiptare (Gonxhe Bojaxhiu) tashmë është bërë udhërrëfim për të shpalosur dimensionin universal të humanizmit, i cili buron kudo në botë në shërbim të jetës së njeriut dhe për të mirën e njerëzimit. Nëna Tereze, - theksoi ai, - me veprën e saj të bamirësisë është bërë simbol i dashurisë për njerëzimin, ndërsa autorët të cilët kanë shkruar për misionin e saj, ndër të tjera, e kanë dokumentuar dhe vetëdijesuar ngadhënjimin e fuqisë shpertërore në përballje me mjerimin dhe vuajtjen njerëzore.

Diana Topalli

EKSPOZITË E FOTOGRAFIVE PËR NËNË TEREZEN

Prishtinë, 16 dhjetor

Në përkujtim të 100-vjetorit të lindjes së "Nënës Tereze", në mjediset e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, është hapur ekspozita e fotografive e titulluar: "Gonxhe Bojaxhiu - Nëna Tereze".

Në këtë ekspozitë, janë paraqitur 61 fotografi - të prezantuara për herë të parë, në vende dhe rrethana të ndryshme nga jeta dhe veprimtaria e Nënë Terezes.

Ekspozita u hap nga koordinatori i Këshillit Organizativ për shënimin e këtij përvjetori, z. Shefki Ukaj, i cili tha, pos tjerash se të fiksosh dhe të paraqesësh figurën e Nënë Terezes përmes fotografive, do të thotë t'u japësh njerëzve mundësinë që t'i njohin disa nga çastet e jetës dhe të veprës së saj të thjeshtë dhe, njëkohësisht, madhore, gjatë të cilës, ajo, me veprën, bamirësinë, humanizmin dhe dashurinë engjëllore, i dhuroi njerëzimit modelin më të përsosur të dashurisë së njëriut për njeriun. Ai, gjithashtu, me këtë rast, vlerësoi lart punën e biografit të Nënës Tereze, Don Lush Gjergji, duke thënë se pa ndihmën e pa kursyer të tij nuk do të ishte realizuar kjo ekspozitë.

Diana Topalli

DONACION NGA POPULLI AMERIKAN PËR BKUK

Prishtinë, 7 dhjetor

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës u organizua ceremonia e dorëzimit të donacionit nga populli amerikan për BKUK-në. Ky donacion u dorëzua nga Znj. Jennifer Washeleski, Asistente e Shefes për Marrëdhënie me Publikun në Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë.

Znj. Jennifer Washaleski, shprehu kënaqësinë për të prezantuar këtë dhuratë nga populli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Departamentin e Koleksioneve të Veçanta të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ajo, ndër të tjerash, tha: "Më 5 shtator 2010, shërbimi postar i SHBA-ve botoi një pullë postare komemorative në vlerësim të shërbimit të jashtëzakonshëm humanitar të Nënës Terezës. Nuk kam nevojë të ju tregoj për historinë e kësaj gruaje madhështore meqenëse është e mirënjohur dhe shumë e dashur në këtë shtet dhe rajon, por dëshiroj ta veçoj faktin se kjo nuk është hera e parë që Nëna Terezë ka pranuar njohje të veçanta nga populli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në vitin 1985, ajo u dekorua Me medaljen Presidenciale të Lirisë nga Presidenti Regan dhe në vitin 1996, Presidenti Klinton i dhuroi asaj nënshtetësi nderi të SHBA-ve.

Kjo dhuratë sot përbëhet nga një panel i 20 pullave postare, një zarf që përmban pullën postare të botuar dhe të përdorur në ditën e parë të botimit (5 shtator 2010) dhe programin e ceremonisë së ditës së parë të botimit (përfshirë këtu edhe zarfin që përmbante këtë program ditë).

Dita e parë e ceremonisë së botimit të pullës postare të Nënës Terezë u mbajt të dielën, më 5 shtator 2010 në Bazilikën e Kishës Kombëtare të ngjizjes hyjnore në Washington D.C., që është kisha më e madhe Romane katolike në Amerikën Veriore. Pas ceremonisë, është mbajtur një meshë për nder të Nënës Terezë.

Ne shpresojmë se ky donacion do të ketë një vend të veçantë në Departamentin e Koleksioneve të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Përkundër madhësisë simbolike, kjo dhuratë përfaqëson vlerësimin e lartë që ekziston ndërmjet dy vendeve tona".

Duke e pranuar këtë donacion nga populli amerikan, drejtori i BKUK-së - Sali Bashota, falënderoi popullin amerikan, institucionet e tij, Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë për këtë dhuratë të rëndësishme të pullave postare me humanisten shqiptare Nëna Tereza.

Diana Topalli

TRAJNIM PËR BIBLIOTEKARË TË FAKULTETEVE DHE TË INSTITUTEVE HULUMTUESE E SHKENCORE

Prishtinë, 04 – 15 tetor

Departamenti i Arsimimit Bibliotekar i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ka organizuar, në Qendrën e trajnimeve të kësaj Biblioteke, trajnim për bibliotekarë të bibliotekave të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës dhe të institucioneve të tjera të rëndësishme hulumtuese e shkencore të Kosovës. Gjatë trajnimit, i cili ka zgjatur 10 ditë, bibliotekarët kanë pasur mundësi të përfitojnë dhe zgjerojnë njohurit e tyre në disa nga fushat kryesore të bibliotekarisë.

Njëri nga sesionet e trajnimit në BKUK

Trajnimi është udhëhequr nga bibliotekarë profesionalë të BKUK-së të fushave të caktuara, si: në atë të legjislacionit për bibliotekat, zhvillimin e koleksioneve të përgjithshme dhe të koleksioneve të veçanta, përkatësisht pasurimin dhe përpunimin fizik të materialeve bibliotekare, në fushën e klasifikimit dhe të katalogimit, inventarizimin dhe sistemimin e materialeve bibliotekare, si dhe në fushën informacionit dhe kërkimeve në internet etj.

Ramize Bajraktari

SIMPOZIUMI NDËRKOMBËTAR: „EDIRNE NË BURIMET ARKIVORE TË SHTETEVE TË BALLKANIT”

Turqi (Edirne), 21 - 23 tetor

Universiteti i Trakisë në Edirne dhe Unioni i Bibliotekave të Ballkanit, organizuan, më 21-23 tetor, në Edirne të Turqisë, simpoziumin ndërkombëtar me temën: „Edirne në burimet Arkivore të shteteve të Ballkanit”.

Republika e Kosovës u prezantua nga përfaqësues të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Arkivi Shtetëror i Kosovës. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, u përfaqësua nga Dr. Sali Bashota, drejtor, Izet Abdyli, sekretar dhe Bukurije Haliti, shefe e Katalogimit.

Në këtë simpozium, përveç anëtarëve nga Kosova dhe Shqipëria, morën pjesë edhe përfaqësues të bibliotekave dhe arkivave të vendeve të

Pjesëmarrës në simpoziumin ndërkombëtar “Edirne në burimet Arkivore të shteteve të Ballkanit”

tjera të Ballkanit, si: Bullgaria, Rumania, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja, Serbia etj.

Në fushën e bibliotekarisë, simpoziumi u zhvillua në sesione të veçanta - në sesionin për burime njerëzore, si dhe në atë të digjitalizimit dhe huazimit të materialeve bibliotekare.

Gjate këtij simpoziumi u trajtuan çështje me interes të veçantë lidhur me burimet arkivore të shteteve të Ballkanit. Arkivit Shtetëror i Kosovës, i udhëhequr nga Dr. Jusuf Osmani dhe Refike Sulçevsi, paraqiti kumtesën me temë: “Komunikimi në mes të Kosovës dhe Edirnes në periudhën osmane”.

Izet Abdyli

NË KUJTIM - JETISH KADISHANI (1948 - 2010)

(Fjalë në mbledhjen komemorative, me rastin e ndarjes nga jeta të mr. Jetish Kadishani, krijues e veprimtar i njohur dhe punëtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës)

Jetish Kadishani (1948 - 2010)

Të nderuar familjarë, kolegë, miq, të pranishëm!

Jetishi ynë, sot na la përgjithmonë... Po vdekja, nuk është fjala e tij e fundit, të pavdekshëm e të përjetshëm e bëjnë veprat, puna e tij e palodhshme ngado e kurdoherë. Jeta prej mësuesi, pedagogu, gazetari, krijuesi i ngrenë atij përmendore përjetësie, për sa të jetë kjo botë...

Ai sikur po e ndiente vdekjen, ndonëse nuk e besoi asnjëherë se do t'i vinte kaq shpejt e kaq papritur... E donte jetën, me vuajtjet e gëzimet e saj, e humor i tij prej krijuesi e bënte të gjallë, të dashur me miq, me kolegë e shokë.

Mua madje sikur më pati lënë një si amanet, të pashkruar sigurisht, po të thënë disa herë ashtu si në tallje, që t'i shkruaja e t'i lexoja letrën e përkujtimit kur të vdiste një ditë...

Sa të vështirë që e kam në këto çaste dhembjeje, sa të rëndë e mora lajmin... Ndoshta edhe për faktin se këtë letër u desh ta shkruaja unë, edhe ta lexoja unë - për mikun, shokun e kolegun tonë... E ku mund t'i gjeja fjalët, ku...?! Ato sikur më lidheshin në fyt... Fjala tashmë mezi dëgjohet, loti është më i fuqishëm e sikur flet më shumë se fjala, miku ynë, kushëriri im... E si mund ta besojmë se nuk je më...?! Edhe në çastet kur po të kërcënonte tinëzisht vdekja e zezë..., Ti sikur po talleshe me të, nuk dorëzoheshe që nuk dorëzoheshe... Dot... Ike nga kjo botë buzagaz e krenar... O çfarë vdekje...!

I dashur Jetish, ta dish që do të na mungosh; ke për të na munguar fort... dhe nuk e di se si do të fillojmë nesër ditën e re të punës pa ty. Nuk e di si do ta pimë kafen e mëngjesit pa ty... Ti ishe përditshmëria, jehu i ditës së re, gëzimi, gjallëria në mesin tonë... Po mbetet tek ne e gjithandej fjala jote e mbetur peng brenda vargut, e thënë mjeshtërisht e ëmbëlsisht në krijimtarinë tënde, tek shpërthen si një dritë në errësirë... Sa fjalë që ke lënë! Dhe sa veprat...! Po dhe sa të tjera të papërfunduara...! Sa kujtimet që ke lënë e sa do të kesh marrë me vete...!

Për të gjitha këto, i përjetshëm qoftë kujtimi për TY dhe faleminderit për gjithçka të vlefshme e të bukur që ke bërë në këtë jetë!

Mirupafshim Jetish! Të them me gojën e të gjithë miqve, kolegëve, dashamirësve...!

Lamtumirë, Jetish Kadishani!

Nexhmije KASTRATI

BIBLIOGRAFI PËR HISTORINË E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE 1844 – 2008, TIRANË, AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË, 2008, 249 F.



Në shenjë të jubileut për 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka botuar bibliografinë e studimeve për alfabetin e gjuhës shqipe. Kjo bibliografia fillon me vitin 1844, kur u botua abetarja e parë e Naum Veqilharxhit, dhe përmbledh shkrimet deri në kohët e sotme. Autorët e kësaj bibliografie janë: Palosh Lulash Daka, Tomor Osmani dhe Maks Gjinaj.

Shkrimet gjatë viteve 1844 - 1878, 2000 - 2007 janë përpiluar kryesisht nga Maksim Gjinaj; shkrimet gjatë viteve 1879 – 1944, janë marrë nga botimi "Bibliografi retrospektive e gjuhësisë dhe onomastikës shqiptare 1879 - 1944"; bibliografi me anotacione, e hartuar sipas të dhënave të shtypit periodik shqiptar e mbi Shqipërinë, të viteve 1848 – 1944, janë përpiluar nga Palok Lulash Daka; shkrimet e botuara gjatë 1946 – 1999, janë përpiluar nga Tomor Osmani.

Kjo bibliografi është e ndërtuar sipas rendit kronologjik: shkrimet janë renditur sipas vitit të botimit dhe brenda vitit është përcjellë renditja alfabetike. Krahas studimeve dhe artikujve që trajtojnë çështjet e alfabetit të gjuhës shqipe, janë përfshirë edhe shkrime ku këto çështje trajtohen në kuadrin e studimeve më të gjera për historinë e gjuhës shqipe.

Kjo bibliografi jep ndihmesë në studimet e mëtejshme për historinë e alfabetit dhe të shkrimit të gjuhës shqipe.

Bibliografia përfshin gjithsej 1602 tituj të librave dhe shkrimeve në përgjithësi dhe, po ashtu, ka treguesin e emrave të autorëve.

MAJLINDA RAPAJ, HYLLI I DRITËS : BIBLIOGRAFI 1913 - 1944, TIRANË, ARGETA LMG, 2009, 95 F.



Bibliografia e shkrimeve të revistës "Hylli i Dritës" përmbledh shkrimet që nga numri i parë i saj në vitin 1913 e deri në vitin 1944. Siç dihet, revista është botuar në Shkodër në shtypshkronjën "Nikaj" dhe është themeluar nga At Gjergj Fishta.

Kjo bibliografi është e ndarë në disa fusha, si: kulturë e përgjithshme, letërsi e folklor, gjuhësi, histori e studime krahinore, biografi dhe nekrologji.

Në këtë bibliografi, është një ndarje e veçantë edhe për Kanunin e Lek Dukagjinit.

Shkrimet brenda fushës kanë radhitje kronologjike dhe alfabetike si dhe të gjitha janë të renditura me numër rendor.

Kjo bibliografi përfshin gjithsej 983 njësi shkrimesh, prej tyre në fushën e kulturës janë 315 njësi, në fushën e letërsisë dhe folklorit - 240 njësi, në atë të gjuhësisë - 57 njësi, Kanuni i Lek Dukagjinit - 3 njësi; histori e studime krahinore - 284 njësi, biografi - 74 njësi dhe nekrologji - 10 njësi.

Bibliografia po ashtu ka edhe treguesin e pseudonimeve, treguesin e autorëve, treguesin gjeografik dhe treguesin e personaliteteve për të cilët flitet.

Bukurije Haliti